

RAPORTI VJETOR I AKTIVITETIT EITI

2016

Sekretariati Shqiptar Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse

EITI Extractive Industries Transparency Initiative
ALBANIA

Parathënie

Ky është raporti i detajuar i aktiviteteve të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse - EITI për vitin 2016, në kuadër të anëtarësimit si vend zbatues në Organizatën Ndërkombëtare EITI International dhe në përmbushje të standartit EITI, veprimtari e cila është shënuar nga arritje pozitive dhe progrese të dukshme e të matshme dhe e vlerësuar në forumet nga partnerët tanë brënda dhe jashtë vendit.

Në vitin 2016, implementimi EITI në Shqipëri hyri në një fazë të re. Ecuria e natyrshme e proçeseve EITI, i ka rritur përgjegjësitë tona duke kaluar nga faza e "perpjekjeve fillestare", në një fazë të re, atë të "zhvillimit të qëndrueshëm" prandaj ne jemi fokusuar dhe kemi investuar në ato aktivitete të cilat do të mundësojnë qëndrueshmërinë dhe konsolidimin e proçeseve EITI.

Natyrisht në qëndër të veprimtarisë tonë ishte pergatitja e Raportit EITI 2015, jo si një qëllim më vete, por si një mjet për të skanuar tërësisht sektorin e Industrive Nxjerrëse në Shqipëri. EITI në Shqipëri dëshiron ta shohë veprimtarinë e saj në rritje vit pas viti. Shqipëria ka deklaruar zyrtarisht në vitin 2015 se në kuadër të transparencës për qeverisjen e burimeve natyrore do të raportojë në EITI edhe sektorin e Hidroenergjisë, në kuadër të mirëqeverisjes së burimeve natyrore, si pjesë e politikës dhe prioriteteve kombëtare për reforma në sektor, dhe nisur nga veshtirësitë që ka sektori, dhe spekulimeve për korrupsion që ndeshen në opinionin publik. Është qëndrimi i qeverisë për të bërë zbardhje të sektorit. Ne konsoliduam për të tretin vit radhazi raportimin vullnetar sipas standartit EITI për sektorin e Hidroenergjive.

Pjesë e ketij proçesi, Ne identifikuam në qëndër të axhendës tonë për vitin 2016 analizën krahasuese të Kuadrit Ligjor Shqiptar dhe Standartit EITI 2016.

Bazuar në gjetjet e identifikuara gjatë përgatitjes së raporteve EITI 2013 dhe 2014, ne identifikuam nevojën të punojmë për rishikimin dhe adoptimin e kuadrit ligjor shqiptar kundrejt kërkesave të Standartit EITI dhe inisiativave të tjera në mënyrë të atillë që të

mundësohet një rrjedhë normale të proçesit të raportimit EITI si dhe puna për hartimin dhe miratimin e dispozitat ligjore dhe ndërlidhjen me ligje të tjera.

Analiza e kuadrit ligjor Shqiptar nënvizoi boshlleqet dhe identifikoi ndryshimet dhe/ose amendimet që duhet të bëhen në atë pjesë të ligjeve që ndërlidhet me proçeset EITI me qëllimin që të sigurohet jo vetëm përputhja me standartin EITI por mbi të gjitha, transparenca dhe llogaridhënia në mënyrën se si të ardhurat e gjeneruara nga industritë nxjerrëse në Shqipëri, mblidhen dhe përdoren.

Një zë të rëndësishëm në veprimtarinë tonë zunë aktivitetet e komunikimit intensive në terren dhe ngritja e kapaciteteve për grupet e interesit. Gjatë proçesit EITI ne kemi identifikuar partnerë të rinj, si studentët, akademikët, ligjvënësit, analistët, parlamentarët, etj. Ata duhet të jenë pjesë e proçeseve EITI dhe çdo komunikim duhet të jetë në përshtatje me specifikat e tyre.

Fuqizimi i MSG-se, rregullimi dhe institucionalizimi i saj ishte gjithashtu në fokus të veprimtarisë sonë për vitin 2016.

Një vlerësim i përgjithshëm i performancës vjetore

Foto Courtesy EITI Albania: Fragment nga Konferenca per shtyp per prezantimin e Raportit EITI 2013+2014

Raporti EITI 2013+2014 u publikua për palët e interesit në Dhjetor 2015.

Në 20 Janar 2016, për publikimin e Raportit EITI 2013 dhe 2014, u organizua një konferencë e përbashkët për shtyp mes Sekretariatit Shqiptar EITI dhe Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë. Ministri i Energjisë dhe Industrisë, z. Damian Gjiknuri dhe Drejtuesja e

Sekretariatit, Znj. Dorina Çinari në fjalën e tyre nënvizuan se transparenca në industrinë nxjerrëse është kontribut për mirëqeverisjen e vendit dhe vlerësuan të dhënat e çertifikuara për sektorët në industrinë nxjerrëse. Përveç taksave dhe pagesave të tjera të kryera ndaj qeverisë nga sektori i naftës, gazit dhe minierave, këto dy raporte përfshinë për herë të parë, deklarimin dhe analizën për transparencën e të dhënave në sektorin e hidroenergjisë. Deloitte Audit Albania, Administratori i Pavaruar, përpiloi dhe koordinoi rakordimin e raporteve EITI për dy vitet fiskale.

Znj. Dorina Çinari, pas publikimit të raportit EITI 2013 dhe 2014, zhvilloi dhe intervistën e parë në median televizive në 7 Janar 2016, ku ju përgjigjë pyetjeve të gazetarit ekonomik rreth gjetjeve të Raportit EITI si dhe objektivave dhe misionin e EITI në tërësi.

Në 24-25 shkurt 2016, Shqipëria si vend implementues EITI, u përfaqësua në Konferencën Globale EITI 2016 mbajtur në Lima, Peru nga institucionet shtetërore, shoqëria civile palë në MSG dhe Sekretariati Shqiptar EITI. Ky aktivitet mat veprimtarinë globale EITI në tre vite dhe në fjalën e tij Ministri i Energjisë dhe Industrisë z. Damian Gjiknuri deklaroi se Shqipëria nga një vend problematik sa i përket transparencës në përgjithësi dhe proçeseve EITI në veçanti, ka shënuar arritje pasi nga një vend gati për "pezullim nga EITI" në Shkurt 2014, arriti të publikojë në periudhën 2014 – 2015 katër raporte EITI në përputhje me standardet EITI, dhe për herë të parë në historinë EITI propozoi raportimin e një sektori të ri atë të Hidroenergjive. Z. Gjiknuri deklaroi edhe një herë mbështetjen e plotë të Qeverisë Shqiptare në proçeset EITI si dhe mbeshtetje të plotë në nismën globale për zbardhjen e Pronarëve Përfitues (Beneficial Owners).

Foto Courtesy EITI Albania: Fragment nga Emisioni "Argument" ne TV Scan i moderuar nga drejtori i lajmeve Enio Civici

Foto Courtesy EITI Albania: Z. Damian Gjiknuri, Minsiter i Energjise dhe Industrise gjate fjales se tij ne Konferencen Globale EITI 2016.

Gjatë qëndrimit në Peru, delegacioni Shqiptar zhvilloi takime me homologë, partnerë të shoqërisë civile dhe drejtuesin e Sekretariatit EITI z. Jonas Moberg. Kryetari i sapo zgjedhur në këtë konferencë i Bordit te EITI, z. Fredrik Reinfeldt takoi delegacionin shqiptar në stendën ekspozuese EITI Albania

Më datë 27-28 prill 2016, u zhvillua në Tiranë për herë të parë Konferenca e Antarëve të Shoqatës Botërore të Kromit. Përfaqësues të kompanive më të mëdha të Kromit dhe të Ferrokromit nga rreth 30 vënde të ndryshme të botës si Afrika e Jugut, Singapori, Kina, Japonia, Turqia, Anglia, Franca, Zvicra, Suedia, SHBA, Italia, India, Belgjika, Emiratet Arabe, etj. u mblodhën për të zhvilluar për herë të parë në Tiranë, konferencën e Antarëve të Shoqatës Botërore të Kromit. Ky takim u organizua nga Shoqata Ndërkombëtare e Zhvillimit të Kromit (ICDA) në bashkëpunim me kompaninë AlbChrome dhe shërbeu si një mundësi për prodhuesit dhe tregtuesit më të mëdhenj të kromit dhe mineraleve në botë për tu njohur me dinamikën e zhvillimit të ekonomisë shqiptare si dhe me mundësinë që ofron tregu i kromit dhe potencialin që kjo industri ka për tregjet e huaja. Ministri i Energjisë dhe Industrisë e mbështeti fjalën e tij në të dhënat e dala nga Raporti EITI 2013-2014 ku theksoi se 76% të prodhimit të brëndshëm minerar e zë kromi.

Në kuadër të zgjerimit të aktiviteteve dhe të mirëqeverisjes së burimeve natyrore, në vitin 2015, EITI Albania doli vullnetare të marrë pjesë në projektin pilot të Deutche Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit (GIZ) për vleresimin e impaktit që ka industria nxjerrese e mineraleve në ekonominë lokale. Në 3 Maj të 2016 Mining Shared Value, një sipërmarrje e Inxhinierëve pa Kufij, Kanada dhe Deutche Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit

(GIZ) filluan në Tiranë implementimin e fazës pilot me Shqipërinë dhe EITI Albania koordinoi të gjithë proçesin e pilotimit.

Aktiviteti nisi me prezantim formal të projektit mbi "Krijimin e një Sistemi të Standartizuar Raportimi mbi prokurimin publik në nivel lokal në zonat minerare", ku EITI Albania ftoi përfaqësues nga institucionet shtetërore, pushteti vendor ku operon industria minerare, kompanitë minerare, shoqëria civile si dhe përfaqësues nga trupa pedagogjike e Fakultetit Gjeologjik të Minierave. Projekti pasoi në qershor 2016 me investigimet në terren, takimet me operatoret me të medhenj të industrive nxjerrëse dhe intervistat me palët e interesit.

Me fokus komunikimin dhe rritjen e vazhdueshme të kapaciteteve, EITI Albania në bashkëpunim me Përfaqësues të Misionit të Bankës Botërore zhvilluan më 9 qershor 2016, një trajnim në Tiranë për anëtarët e MSG, institucioneve shtetërore pjesë e proçesit EITI, shoqëri civile të tjera të interesuara në proçeset EITI dhe stafin e Sekretariatit Shqiptar. Gjatë prezantimit u theksua dhe u vlerësua progresi i Shqipërisë në zbatimin e Standartit EITI si dhe u diskutuan sfidat e mëtejshme dhe aktivitetet që do kontribuojnë në implementimin efektiv të reformave në industrinë nxjerrëse.

Trajnimi u fokusua në dy zhvillime të rëndësishme të EITI në 2016, a) Prezantim dhe njohje me standartin EITI 2016, efektet që do të shkaktojë ai në raportimet e ardhshme apo vetë proçeset EITI si dhe b) trajnim i detajuar mbi Përfituesit Real (Beneficial Owners), definicionet, praktikat botërore dhe pritshmëritë e proçesit EITI deri në 2020.

Qeveria e Kosovës dhe palët e interesit atje kanë shprehur interes të përsëritur ti bashkohen Nismës për Transparencë në Industritë Nxjerrëse. Ata janë drejtuar me disa komunikime EITI Albania përgjatë 2016 me ftesa për bashkëpunim dhe kërkesa për mbështetje në proçesin EITI për Kosovën. Natyrisht që gjithë sa më sipër ka gjetur mbështetjen e plotë të EITI Albania.

Në 24-25 Qershor 2016 Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur së bashku me Eurasia Hub organizuan një trajnim me grupet e interesit të Kosovës mbi Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse EITI. EITI Albania ishte palë në të gjitha ditët e këtij aktiviteti së pari si trajnues për EITI dhe gjithashtu duke përcjellë tek të pranishmit përvojën shqiptare, progresin e Shqipërisë në EITI, që nga përpilimi i Raporteve të para dhe deri në zgjerimin e

sferës EITI duke përfshirë për herë të parë në Raportet EITI 2013 dhe 2014 sektorin hidroenergjitik.

Po ashtu, me kërkesë të Qeverisë së Kosovës, në kuadër të hartimit të politikave dhe strategjive zhvillimore të sektorit minerar dhe anëtarësimin e Kosovës në Nismën Ndërkombëtare EITI, Sekretariati Shqiptar EITI organizoi në 6 Tetor 2016 në Tiranë takimin dy palësh mes përfaqësuesve nga Departamenti i Minierave në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik në Republikën e Kosovës, Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit Minerar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë në Tiranë dhe EITI Albania. Takimi pati një seancë të plotë trajnimi mbi EITI. Gjithashtu u prezantuan dhe diskutuan përvoja dhe sfidat e Shqipërisë në proçeset EITI që nga fillimet e saj. Drejtuesja e Sekretariatit Shqiptar, Znj. Dorina Çinari shprehu mbështetjen e saj për ta ndihmuar shtetin e Kosovës në rrugën drejt anëtarësimit në EITI, nisur dhe nga përvoja që Shqipëria ka sot si një vënd anëtar në EITI.

Në Korrik – Gusht 2016 në kuadër të punës parapërgatitore për Raportin EITI 2015, Sekretariati Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse zhvilloi një seri takimesh në zonat ku operon industria nxjerrëse me përfaqësues të kompanive nxjerrëse, përfaqësues të pushtetit vendor, shoqërinë civile që operon në këto zona si dhe banore. Takimet u mbajtën në qytetet ku është e përqëndruar më shumë industria nxjerrëse. Këto takime kishin për qëllim trajnimin e pjesëmarrësve mbi plotësimin e raportimit për EITI, si dhe u diskutua për pagesat që kompanitë kryejnë ndaj pushtetit vendor, investimet në komunitet, renta minerare e përfituar etj.

Po në këtë vazhdë takimesh të përmendura më lart, në 6 Shtator 2016, Administratori i Pavarur "Deloitte Audit Albania" dhe Sekretariati Shqiptar EITI zhvilluan në ambjentet e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, seminarin e përvitshëm trajnues mbi proçesin e mbledhjes së të dhënave, analizën dhe mënyrën e raportimit EITI. Të gjitha kompanive dhe institucioneve raportuese iu vunë në dispozicion instruksionet dhe formularët e deklarimit përkatëse për Raportin EITI 2015.

Përgjatë këtij takimi, u zhvillua një sesion i plotë trajnimi dhe informimi i raportuesve në EITI mbi Pronarët Përfitues (Beneficial Owners) dhe kërkesat e ardhëshme të raportimit të

detyruar për BO në 2020. U dhanë definicione të plota mbi atë se cilët quhen BO dhe u pajisën me një formular sqarues.

Në kuadër të përgatitjes së raportit EITI, në këtë aktivitet Operatorëve iu kërkua të pilotohet me raportimin për BO sipas formularit të vënë në dispozicion dhe definicioneve të dhëna në trajnim. Rezultatet e këtij piloti janë raportuar në Raportin EITI 2015.

Gjatë periudhës Shtator – Nëntor 2016, Sekretariati Shqiptar EITI zhvilloi për të tretin vit radhazi Anketën EITI. Ky anketim u zhvillua në kuadër të hartimit të një Strategjie Komunikimi sa më efikase për rritjen e impaktit dhe diskursit publik në kuader të mirëqeverisjes së burimeve natyrore në nivel kombëtar. Pyetësori konsistoi në 21 pyetje, për të dhëna se sa njohuri kanë qytetarët e Shqipërisë rreth industrisë nxjerrëse dhe a është investuar mjaftueshëm në komunitetin e tyre nga të ardhurat që sjell kjo industri në arkën e buxhetit të shtetit. Ky anketim u zhvillua në qytetet Burrel, Krastë, Bulqizë, Patos, Fier, Vlorë, Selenicë, Librazhd, Përrenjas, Pogradec, Rrëshen, Kukës, Vau Dejës dhe Tiranë. Në secilën zonë u anketuan 100 qytetarë. Gjithashtu u organizuan takime me nxënësit e shkollave të mesme mbi rolin që Nisma EITI luan për zhvillimin e komunitetit.

Në kuadër të hartimit të një Strategjie Komunikimi sa më efikase, Konsulenti Individual Znj. Emanuela Zaimi, përgatiti për MSG dhe EITI Albania, "Strategjinë Finale të Komunikimit dhe Plan Veprimi EITI, Nëntor 2016-Dhjetor 2017". Strategjia e Komunikimit morri dhe pëlqimin unanim të MSG-se se EITI Albania dhe Sekretariatit EITI.

EITI Albania and FIAA - Foreign Investors Association of Albania, nënshkruan në Tetor 2016 një Marrëveshje Bashkëpunimi ku FIAA u konsolidua si partnerja e EITI Albania në përpjekjet për të promovuar principet e Transparencës në mes të investitorëve në këtë sektor, në përpjekjet e përbashkëta për ngritjen e kapaciteteve dhe në shkëmbimin e eksperiencave më të mira. Gjithashtu FIAA do të shërbejë edhe si organi që do të adminstrojë proçeset e përzgjedhjes së kompanive në MSG-në e EITI.

Në 27 Tetor 2016, BALcanOSH.net-Regional CSOs, dega Tiranë, organizuan në Tiranë një aktivitet me temë "Rritja e kapaciteteve dhe forcimi i rolit të organizatave të shoqërisë civile rajonale për përmirësimin e kushteve të punës dhe dialogun e punës me institucionet publike". Sekretariati Shqiptar EITI e mbështeti këtë aktivitet duke synuar që në raportet e

ardhshme EITI të pasqyrohen më shumë të dhëna dhe problematika të lidhura me kushtet e punës, sigurimin në punë, numrin e punonjësve dhe pagesat e sigurimit dhe të shëndetit në punë, duke rritur nivelin e transparencës në sektorin e industrisë nxjerrëse. Në këtë aktivitet morrën pjesë përfaqësues nga shoqëritë civile, sindikatat, bashkitë, Sekretariati Shqiptar EITI, ekspertë vendas dhe të huaj në këtë fushë, si dhe pjesmarrës nga media e shkruar dhe ajo televizive.

Në 27-29 Tetor 2016, Sekretariati Shqiptar EITI morri pjesë në Edicionin e Tretë të Panairit "Energjia dhe Ndërtimi", i cili u organizua nga Tirana Expo Centre në bashkëpunim me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë organizuan. Në fokus të panairit ishte nxitja dhe zhvillimi i industrisë vendase. Ne u bëme pjesë e këtij eventi për të dytin vit radhazi duke prezantuar Raportin EITI 2013-2014, Raportin Përmbledhës 2013-2014, Udhërrëfyesin EITI dhe Fletëpalosjen EITI.

EITI Albania ka dhënë kontributin e saj disa herë përgjatë 2016, në zbutjen e konflikteve mes palëve të interesit në komunitetet ku operojnë industritë nxjerrëse, duke komunikuar qartë dhe në mënyrë transparente me banorët gjithë informacionin që zotëron.

CAO, Complaince Ombudsman/Advisor dhe Sekretariati Shqiptar EITI organzuan disa takime me banorët e zonës naftëmbajtëse të Marinzës, si zona më e madhe naftëmbajtëse në Shqipëri. Përfaqësues nga kompania Bankers Petrolium, Shoqëria Civile dhe drejtues të Bashkisë Roskovec trajtuan dhe nxitën diskutime rreth përdorimin të të ardhurave për nevojat e komunitetit dhe problemeve të ndotjes së mjedisit.

Në përputhje me objektivat qëndrore të EITI për 2016, Sekretariati Shqiptar EITI përgatiti për MSG draft udhërrëfyesin e aktiviteteve për arritjen e raportimit të Përfituesve Realë në 2020. Ky dokument rreshtoi aktivitetet e pritëshme, resurset e nevojshme, buxhetet dhe palët e interesit që do të përfshihen në proçes. Ky dokument u shpërnda për komente dhe sygjerime në MSG dhe në 31 Dhjetor 2016 u publikua zyrtarisht.

Po ashtu, u finalizua dhe u paraqit për komente në MSG Analiza krahasuese e Kuadrit Ligjor Shqiptar dhe Standartit EITI 2016, përgatitur nga kompania konsulente EUROSUPPORT srl.

Analiza paraqiti nje skanim të bazës ligjore shqiptare për çdo kërkesë të standartit EITI dhe solli propozime të rëndësishme që do të jenë në proçes miratimi për 2017. Tashmë kemi një propozim të plotë për të ndërtuar Ligjin Shqiptar për Transparencën e Industrive Nxjerrëse dhe Burimeve Natyrore.

Në 13 Dhjetor 2016, në bashkëpunim me Drejtorinë e Politikave Minerare në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë dhe Prefekturën e Qarkut Kukës, Sekretariati Shqiptar EITI organizoi tryezën e rrumbullakët me operatorët e industrive nxjerrëse që operojnë në këtë qark. Përfitimet që ka industria nxjerrëse nga raportimet EITI, përbën dhe thelbin e diskutimeve konstruktive.

Në 15 Dhjetor 2016, MSG e EITI Albania në bashkëpunim me AlbChrome, e përmbyllën vitin 2016, me vizitën në Qëndrën e Drejtimit dhe Kantierin e Minierës Albchrome ku vëzhguan nga afër terrenin e punës. Objektivi i kësaj vizite ishte rritja e bashkëpunimit mes kompanive operuese në vend dhe Sekretariatit EITI.

Natyrisht që veprimtaria qëndrore e EITI Albania ka qënë përgatitja e raportit EITI 2015. Proçesi filloi në Korrik 2016 dhe përfundoi në Dhjetor 2016. EITI Albania ka koordinuar një veprimtari tejet voluminoze në një proçes masiv. Pas raportimeve të marra nga Administratori i Pavarur, Deloitte Audit Albania se disa kompani operuese në sektorin e industrive nxjerrëse nuk kishin raportuar të dhënat e pagesave të kryera në shtet për vitin fiskal 2015, Sekretariati Shqiptar EITI filloi takime të drejtpërdrejta në kantieret e punës, me drejtuesit e subjekteve qe nuk po raportonin. Keshtu ndodhi me drejtuesit e subjektit "Brajani 2013" dhe kompani të tjera që nuk kishin raportuar akoma per vitin 2015 me qëllim për të ndihmuar kompani të veçanta në mënyrën e raportimit, apo me kompaninë H/C "AYEN AS Energy sh.a" për të përforcuar shembullin pozitiv tek kompanitë e H/C në respektimin e afateve e cilësisë në raportimin EITI duke theksuar në këtë mënyrë se raportimi EITI së pari është një detyrim ligjor dhe së dyti është një kontribut në transparencën e plotë të sektorit nxjerrës në Shqipëri.

Ngritja e kapaciteteve dhe trajnimi i vazhdueshem në mirëqeverisjen e burimeve natyrore për palët e interesit të përfshira në proçeset EITI ka qënë gjithashtu në fokus të 2016.

Në Dhjetor 2015, EITI Albania solli për palët e interesit trajnime të personalizuara mbi Mirëqeverisjen e Burimeve Natyrore nga Columbia University dhe Earth Institute NY. Ne organzuam trajnime për Gazetarët, Parlamentaret, Akademikët, MSG dhe të interesuar të tjerë mbi: paketat fiskale, kuadri ligjor, mbrojtja e ambjentit, impakti ekonomik etj.

Nën kujdesin dhe mbështetjen programatike të EITI për ngritjen e kapaciteteve në adminsitrimin e burimeve natyrore, Drejtoria ligjore e Ministrisë së Energjisë e cila ballafaqohet fort me mosmarrëveshjet që lindin mes palëve në ekzekutimin e kontratave koncesionare, dërgoi për trajnim më të thelluar përfaqësuesit e vet në trajnimin e specializuar mbi Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe Arbitrazhin Ndërkombëtar ofruar nga Columbia University, NY.

Në këtë kuadër, EITI Albania ka filluar koordinimin përgjatë Dhjetor 2016 me Columbia University dhe Houston University që në kuadër të trajnimit të vazhdueshëm dhe cilësor të kuadrove, të dërgojë për trajnime më të thelluara 8 përfaqësues të tjerë nga rrjeti EITI shqiptar në 2017. Përfaqësues të Minsitrisë së Financave, Drejtorisë të Taksave, Drejtorisë Hidrokarbure dhe EITI do të jetë pjesë e trupës që do të ndjeki trajnimet në vazhdim.

Vlerësimi i performancës kundrejt objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara në planin e punës

Objektivi 1 Plani i Punës 2016

Plani i Punës EITI 2016 ju dërgua me qarkore për diskutime dhe propozime te tjera antarëve të MSG më datë 3 shkurt 2016 dhe më datë 17 shkurt 2016 u miratua unanimisht nga EITI Albania MSG. Plani i Punës EITI 2016 u përpilua në përputhje me standartin EITI dhe u publikua në faqen zyrtare të Sekretariatit Shqiptar EITI menjehere pas miratimit.

Objektivi 2 Raportimi i aktiviteteve vjetore 2015

Referuar objektivave dhe aktiviteteve të planit të punës EITI 2015, Sekretariati Shqiptar EITI bëri një vlerësim të performancës dhe ecurisë së punës përgjatë vitit 2015. Viti 2015 bëhet viti i dytë ku Sekretariati Shqiptar EITI publikoi dy raporte, Raportin EITI 2013 dhe Raportin EITI

2014. Këto dy raporte përfshinë për herë të parë deklarimin dhe analizën për transparencën e të dhënave në sektorin e hidroenergjisë. Rol të veçantë përgjatë vitit 2015 luajtën edhe publikimet e disa studimeve si *"Studimin mbi kapacitete potenciale të të ardhurave nga Industria nxjerrëse"* me synim informimin e publikut dhe rritjen e transaprencës mbi të ardhurat potenciale nga industria nxjerrëse. Risia e përfshirjes së sektorit të hidroenergjisë për herë të parë të burimeve ujore në raportet EITI 2013 dhe EITI 2014, kërkoi të përgatitej dhe paraqitej së pari një *"Studim fizibiliteti mbi burimet hidro"* në Shqipëri. Publikimi i *"Studim fizibiliteti për sistemet e integruara të të dhënave EITI"*, një studim i bazuar mbi sistemet aktuale të të dhënave dhe mundësia e një gjenerimi të një sistemi ku të gjenerohen automatikisht të dhënat për raportin EITI. Gjithashtu, Sekretariati Shqiptar EITI publikoi studimin *"Harta Ushtrimore e Industrisë Nxjerrëse"*, për mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e të dhënave EITI në 9 zona të industrisë nxjerrëse.

Objektivi 3 MSG

MSG Shqiptar EITI në mbledhjet e zhvilluara miratoi ToR për Raportin EITI 2015; Miratimin e listës së kompanive që do të marrin pjesë në raportim, referuar arsyetimit mbi pragun e materialitetit; ToR për Administratorin e Pavarur 2015-2016; Miratimin e përfshirjes në Raportin EITI 2015 të pagesave për taksat lokale me kufi materialiteti 5000 USD; Pasqyrimi në mënyrë të disagreguar në Raportin EITI 2015 të pagesave të bëra për vepra publike dhe infrastrukturë sipas detyrimeve kontraktuale si dhe pagesat apo investimet që bëhen nga kompanitë në kuadër të përgjegjësisë sociale me kufi materialiteti 5000 USD; ToR për Konsulencën Lokale dhe Ndërkombëtare për shqyrtimin e kuadrit ligjor dhe Rregullator Shqiptar; Planin e Punës 2016 dhe Strategjinë e Komunikimit EITI 2016-2017. Për të gjitha vendimet MSG dhe Sekretariati Shqiptar EITI u konsultuan me palët e angazhuar në proçesin EITI duke marrë në konsiderat sygjerimet e ndryshme nga secila palë e interesuar.

Gjithashtu, gjatë vitit 2016, Sekretariati Shqiptar EITI ka paraqitur në MSG një sërë çështjesh për tu trajtuar, për miratim etj.

Në fillim të Janarit 2016 MSG-së i është përcjellë kërkesa për Organizatat e Shoqërisë Civile nga Publish What you Pay për të marrë pjesë në proçesin e nominimeve dhe zgjedhjeve për në bordin e ri të EITI-t. Në muajin Shkurt me asistencën e Sekretariatit Shqiptar EITI u

organizua një takim mes përfaqësuesve të Shoqërisë Civile në MSG-në shqiptare dhe përfaqësuesve të Donatorit Banka Botërore, ku u diskutua mbi rëndësinë e rolit të CSO-ve në rritjen e ndërgjegjësimit publik në drejtim të Transparencës.

Në fillim të muajit Shkurt është dërguar për komente, diskutim dhe miratim Raportin e Aktiviteteve i EITI Shqipëri për vitin 2015.

Në Korrik 2016 Shqipëria është ftuar nga Sekretariati Ndërkombëtar EITI që të marr pjesë në një projekt pilot për shtrirjen e transprencës në tregëtimin e produkteve të naftës, gazit, minerare etj. MSG-ja shqiptare u tregua e gatshme për tu bërë pjesë e këtij projekti pilot.

Në muajin nëntor i është paraqitur MSG-së për komente dhe miratim Udhërrëfyesi për Përfituesit realë/ Road map for Beneficial Ownership.

EITI Albania dhe MSG punuan përgjatë Vitit 2016 edhe rregulloren e re të veprimtarisë së MSG-së nën dritën e zhvillimeve të proçesit EITI në Shqipëri, konsolidimit të veprimtarisë së saj dhe kërkesave të reja të standartit EITI. Pasi u diskutua, u bënë ndryshime dhe komente nga ana e MSG-së rregullorja u dërgua për mendim në Bankën Botërore dhe në EITI International, Oslo. Rregullorja e re u nënshkrua në Dhjetor 2016 nga Ministri i Energjisë Z. Damian Gjiknuri dhe u publikua në faqen zyrtare të EITI Albania.

Objektivi 4 Shqyrtimi ligjor dhe rregullator

Sigurimi i një legjislacioni të qëndrueshëm për zbatimin EITI në Shqipëri duke përmirësuar udhëzimet, urdhërat ekzistues dhe aktet nënligjore lidhur me raportimin EITI ka qënë një nga temat kyçe të diskutimeve në mbledhjet e EITI Albania MSG. Në vijim të iniciativës për rishikime të kuadrit ligjor, Sekretariati Shqiptar EITI përzgjodhi kontraktorin Eurosupport-Fineurop Support S.r.l. Drafti final i raportit u dërgua në 30 Dhjetor 2016 , i cili u trajtua dhe diskutua gjerësisht në një prezantim të hapur të organizuar nga Sekretariati Shqiptar EITI gjatë Janar 2017. Dokumenti mori miratimin e MSG dhe palëve të përfshira në 10 Shkurt 2017.

Objektivi 5 Strategjia e Komunikimit 2016-2017

Fushata e parë e komunikimit gjatë 2011-2013 të EITI Albania dhe MSG kishin në fokus fazën njohëse për EITI dhe ndertimin e një themeli për promovimin e EITI në Shqipëri, veçanërisht në zonat e prodhimit.

Fushata e dytë e komunikimit gjatë vitit 2015 vuri në fokus krahas parimeve dhe përfitimeve konkrete nga EITI, dhe të dhënat e para krahasuese të paraqitura nga 4 raportet e EITI, EITI 2009, EITI 2010, EITI 2011, dhe EITI 2012.

Me Strategjinë e Komunikimit 2016 -2017, EITI Albania dhe MSG, kanë për qëllim njohjen e publikut të gjerë me rezultatet e raportit EITI 2013 dhe 2014 dhe në vazhdim ato të raportit të ri EITI 2015 i cili u publikua në Janar 2017. Strategjia e re e komunikimit kërkon që informacioni të rrjedhë në të gjitha drejtimet njëkohësisht dhe të prekë të gjitha grupet e synuara. Qëllimi final është që të ndihmojë palët e interesuara të angazhohen në dialog mes palëve për çështje të qeverisjes burimeve natyrore dhe çështjet e EITI, me qellim final formëzimin e politikave dhe reformave të nevojshme në sektor.

Konsulenti Individual Znj. Emanuela Zaimi, kontraktuar sipas proçedurës së Prokurimit IC të Bankës Botërore dhe miratuar nga MSG me vendim nr.3, datë 31.10.2016, dorëzoi pranë zyrave të Sekretariatit Shqiptar EITI, "Strategjinë Finale të Komunikimit dhe Plan Veprimi EITI, Nëntor 2016-Dhjetor 2017". Sekretariati Shqiptar EITI me anë të kësaj strategjie kërkon të shënjestrojë, grupet e interesit si komunitetet lokale, qeverinë vendore, institucionet shtetërore, organizatat e shoqërisë civile, operatorë të industrisë nxjerrëse, gazetarë, studentë etj dhe përzgjedhjen e kanaleve të komunikimit me impakt të madh për rritjen e nivelit të perceptimit publikë në mirëqeverisjen e sektorit nxjerrës. Gjithashtu Sekretariati Shqiptar EITI duke parë dhe problematikat e ngritura në takimet e zhvilluara gjatë "Anketës EITI 3", në Strategjinë e re të Komunikimit Nëntor 2016 - Dhjetor 2017, ka përfshirë një sërë aktivitetesh informuese për qytetarët si: zhvillimi i tryezave të rrumbullakta me shoqërinë civile, gazetarët, konferenca për shtyp për raportin EITI 2015 dhe 2016, seminare të hapura me studentët e fakultetit gjeologji miniera, gazetarisë, financës, ekonomisë, fushata ndërgjegjësuese në zonat nxjerrëse dhe seminare informuese për banorët e komuniteteve të prekura nga industria nxjerrëse, fushata në televizione kombëtare dhe lokale, trajnimin e

stafeve të pushtetit lokal si dhe shumë aktivitete të tjera gjithë përfshirëse. Strategjia e Komunikimit morri dhe pëlqimin unanim të EITI Albania MSGt Shqiptar EITI.

Proçesi i anketimit në komunitete, ai i formëzimi të strategjisë sipas objektivave për tu arritur, listimi i aktiviteteve të komunikimit të nevojshme të kryhen për të arritur impakt dhe në fund proçesi i tenderimit për këto aktivitete, treguan që në mënyrë që të arrihen disa tregues të mirë perceptimi dhe ndërgjegjësimi në publik, nevoitet të kryhen aktivitete shumë intensive dhe masive me burime dhe kosto të konsiderueshme financiare. Megjithë përpjekjet e brendëshme të EITI Albana për të gjeneruar rezultate, burimet aktuale të EITI Albania janë mjaft të kufizuara për këtë qëllim.

Objektivi 6 Aktivitete komunikimi

- Publikimi i raportit EITI 2013-2014 vijoi me një konferencë të madhe për shtyp. Scan TV bëri një pasyrim të dejauar të raportit EITI në emisionin "Argument" drejtuar nga gazetari ekonomik Enio Civici. http://youtu.be/7JeWBLyJyjI
- Pas lançimit të Raportit EITI 2013 dhe 2014, Sekretariati Shqiptar EITI organizoi një sërë takimesh dhe seminare me të gjitha grupet e interesit. Raporti EITI 2013 dhe 2014 ju dërgua përfaqësuesve të komanive nxjerrëse, njësive vendore, shoqërisë civile, donatorëve, institucioneve të qeverisjes qëndrore, grupeve parlamentare, grupeve ambjentaliste etj. Sekretariati Shqiptar EITI gjithashtu organizoi takime me studentë dhe nxënës të shkollave të mesme në qytetet ku operon industria nxjerrëse. Gjatë këtyre takimeve u prezantuan Raporti EITI 2013 dhe EITI 2014 si dhe u fol mbi rëndësinë që ka implementimi i Nismës EITI në zhvillim të komunitetit. Një seri takimesh sensibilizuese dhe informuese u organizuan me kompanitë që operojnë në industrinë nxjerrëse. Për të qënë sa më produktivë, ne printuam Raportin EITI 2013-2014, Raportin Përmbledhës 2013-2014, Udhërrëfyesi dhe Fletëpalosjet EITI, raporte të cilat u shpërndanë tek të gjitha grupet e interesit, të ftuara e pjesëmarrës në seminare dhe aktivitetet e organizuara nga Sekretariati Shqiptar EITI.
- Ministri i Energjisë dhe Industrisë Z.Damian Gjiknuri mori pjesë në konferencën dy ditore Globale të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, e cila u zhvillua në Lima të Perusë. Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI) është një iniciative ndërkombëtare e institucionalizuar në vitin 2002, me nismën e Kryeministrit

të Britanisë së Madhe. Standardi EITI, nënkupton vendosjen e transparencës së biznesit në industrinë nxjerrëse, në mënyrë që të ardhurat nga ky biznes të kontribuojnë më shumë në zhvillimin e vendit. Në fjalën e tij para të pranishmëve, ministri Gjiknuri deklaroi se Shqipëria nga një vend problematik tanimë ka shënuar arritje pasi në dy vitet e fundit ka publikuar disa raporte në përputhje me standardet EITI."Në 20 vitet e fundit ekonomia ka ndryshuar por ende industria nxjerrëse dhe industritë e lidhura me mineralet, naftën dhe gazin luajnë një rol të rëndësishëm për Shqipërinë. Transparenca për mënyrën se si këto burime janë duke u përdorur bëhet shumë e rëndësishme", u shpreh ministri Gjiknuri.

Z.Gjiknuri kërkoi që nisma EITI të mund të zgjerohet duke përfshirë si aktorë kryesorë shtetet e mëdha me synim rritjen e transparencës. Gjatë diskutimeve të zhvilluara në konferencë, një prej objektivave të ardhshëm të EITI-it në nivel global ka të bëjë me identifikimin e pronarëve të vërtetë të kompanive që shfrytëzojnë burimet natyrore të vendeve anëtare.

"Ka shumë arritje, por ka ende shumë për të bërë. Kjo është një iniciativë shumë e mirë, pavarësisht se është një iniciativë e një grupi të vogël vëndesh. Ne këtu bëmë diskutime se si do të rrisim transparencën, si të luftojmë korrupsionin. Transparenca është me shumë rëndësi për të kuptuar se kush janë pronarët e vërtetë të kompanive që shfrytëzojnë burimet natyrore. A do të jemi ne në gjendje që përmes kësaj iniciative të vogël të bëhemi global, duke shtuar shtetet anëtare dhe të imponojmë transparencën se cilët janë pronarët e vërtetë të kompanive që shfrytëzojnë burimet natyrore", deklaroi z.Gjiknuri. Gjatë qëndrimit në Peru, Ministri Gjiknuri zhvilloi takime me homologë dhe Drejtuesin e Sekretariatit EITI z. Jonas Moberg. Ky i fundit përgëzoi Shqipërinë për punën e bërë gjatë dy viteve të fundit në publikimin e disa raporteve në përputhje me standardet e transparencës.

- Mining Shared Value, një sipërmarrje e Inxhinierëve pa Kufij, Kanada dhe Deutche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) me mbështetjen e Sekretariatit Shqiptar EITI, më 3 Maj 2016, në "Rogner Hotel Tirana" zhvilloi një takim joformal, për prezantimin e projektit mbi "Krijimin e një Sistemi të Standartizuar Raportimi mbi prokurimin publik në nivel lokal në zonat minerare". Në takim ishin të pranishëm përfaqësues nga institucionet shtetërore qëndrore si: Ministria e Energjisë dhe

Industrisë, Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, pushteti vendor i zonave ku operon industria minerare, përfaqësues nga kompanitë minerare, shoqëria civile, fakulteti i Gjeologji Minierave, etj. Projekti ka për qëllim të pasqyrojë mundësitë dhe sfidat që kompanitë minerare kanë në lidhje me blerjen dhe raportimin mbi mallrat dhe shërbimet e blera nga kompanitë lokale. Nëpërmjet zhvillimit të takimeve me kompanitë minerare dhe njohjes me mënyrat se si ata e trajtojnë këtë çështje, do të zhvillohet një standart i cili mund të ofrojë udhëzime se si prokurimi vendor mund të plotësojë nevojat e minierave dhe njëherësh edhe pritshmëritë e komuniteteve lokale. Përmes prokurimit publik në nivel lokal, kompanitë mund të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të komuniteteve dhe të mbështesin interesat afatgjata të minierave. Kompanitë që ndajnë perspektivën e tyre për këtë projekt do të ndihmojnë në zhvillimin e një dokumenti faktik për të gjitha kompanitë për raportim dhe zbatim.

- Tirana Expo Centre në bashkëpunim me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë organizuan nga data 27-29 Tetor 2016, Edicionin e Tretë të Panairit "Energjia dhe Ndërtimi", me fokus nxitjen e industrisë vendase dhe rritjes së ndërveprimit rajonal në sektorët e energjisë së rinovueshme, eficensës në energji, shfrytëzimit të energjisë alternative, ndërtimit, hidrokarbureve etj. Sekretariati Shqiptar EITI për të dytin vit radhazi u bë pjesë e këtij eventi, duke prezantuar Raportin EITI 2013-2014, Raportin Përmbledhës 2013-2014, Raportin Përmbledhës 2011-2012, Udhërrëfyesin EITI dhe Fletëpalosjen EITI. Aktiviteti pati një mbulim tepër të gjerë dhe interes të madh mediatik.
- Ne daten 13 Dhjetor 2016, EITI Albania në bashkëpunim me përfaqësuesit e Drejtorisë së Politikave Minerare në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë dhe Prefekturën e Qarkut Kukës, organizuan tryezën e rrumbullakët me Operatoret e Industrive Nxjerrëse që operojnë në këtë qark. Në thelb të takimit ishte nisma EITI, përfitimet që ka industria nga raportimet dhe pjesëmarrja në EITI, liçensa sociale që marrin nga komuniteti, vështirësitë konkrete në proçesin e raportimit, si dhe u sqaruan paqartësi të lidhura me detaje të raportimit. Më pas problematikat që lidhen me qeverisjen e sektorit dhe sfidat e operatorëve në terren u diskutuan me Z. Mehmet Hasanlami, Drejtori i politikave në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë.

https://www.facebook.com/eitialbania/?ref=bookmarks

- Përgjatë gjithë 2016, Sekretariati i dha një fokus shumë të madh informacionit të vazhdueshëm për grupet e interesit. Ne synuam të mbajmë me informacion të përditësuar me postime të vazhdueshme të aktiviteteve tona në Shqipëri EITI-dashësit nëpërmjet faqes tonë zyrtare @EITI Albania në rrjetin social facebook si dhe faqen zyrtare të internetit www.albeiti.org. Përmirësimi i faqes web dhe përfshirja në të e rubrikave me pyetje dhe komente për EITI dhe problematikën që ajo ndjek nga specialistë, investitorë, subjekte shtetërore e private, vendase dhe të huaj ka qënë objektiv konstant.

Objektivi 7 ***Raporti EITI 2015***

Përgatitja e raportit EITI 2015 filloi në Gusht 2016. Termat e Referencës për Raportin EITI 2015, u diskutuan dhe u miratuan nga EITI Albania MSG nga EITI International dhe Banka Botërore. Administrator i Pavarur, u rizgjodh Deloitte Audit Albania.

Bazuar në Raportet EITI të mëparshme dhe kërkime të tjera, MSG-së vendosi që Raporti EITI 2015 të mbulojë :

- Të dhënat e marra prej 8 agjencive qeveritare .
- 15 lloje pagesash të bëra prej rreth 107 kompanive dhe agjencive të tjetra qeveritare ose qeverisjeve vendore (shih aneksin 1)
- 9 kompani nga sektori hidrokarbur (Sektori 100 %),
- 15 kompani nga sektori hidroenergjetik (Sektori 97 %),
- 83 kompani nga sektori minerar (Sektori 88 %),

Nisur nga veshtiresitë e viteve të kaluara, duke trajtuar problemin e vonesave në grumbullimin e deklarimeve të subjekteve, MSG e përfaqesuar nga Z. Ilir Bejtja dërgoi në Gusht 2016 kërkesa për angazhim të menjëherëshëm tek të gjithë operatorët dhe agjensitë shtetërore të angazhuara në raportim.

Në 6 Shtator 2016, në ambjentet e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Administratori i Pavarur Deloitte Audit Albania dhe Sekretariati EITI Shqipëri, së bashku, zhvilluan një seminar informues për kompanitë dhe institucionet raportuese mbi proçesin e mbledhjes së të

dhënave dhe mënyrën e raportimit për Raportin EITI 2015. Të pranishmëve iu vunë në dispozicion të gjitha instruksionet dhe formatet përkatëse për raportimin EITI 2015.

Megjithë angazhimin e madh të palëve të përfshira në raport, të dhënat për raportin EITI u gjeneruan me veshtirësi si nga ana e operatorëve ashtu edhe nga agjencitë qeveritare. Ne nuk arritëm dot publikimin brënda afatit që kishim objektin në 31 Dhjetor 2016. Drafti final u shpërnda për palët e inetersit në 17 Janar 2017 dhe mori miratimin final në 1 Shkurt 2017.

Administratori i Pavarur Deloitte Audit Albania i dërgoi Sekretariatit Shqiptar EITI një email sqarues ku thekson se vonesat në raportim nuk mundësonin publikimin e Raportit EITI 2015 në muajin Dhjetor 2016. Raportit EITI 2015 pritet të publikohet në muajt e parë të vitit 2017.

Objektivi 8 ***Validimi EITI 2016***

Bazuar në Standartin e ri EITI, ishte parashikuar që Shqipëria ta niste proçesin e Validimi më 1 Tetor 2016. Bordi i EITI vendosi shtyrjen e afatit te validimit për Shqiperinë në Prill 2017.

Objektivi 9 ***Studimi mbi transparencën në përdorimin e të ardhurave nga renta dhe donacionet e kompanive të industrisë nxjerrëse në pushtetin vendor***

Të dhënat që i përkasin këtij studimi ka qënë pjesë e objektit dhe janë përfshirë në raportin EITI 2015

Objektivi 10 ***Sondazhe mbi impaktin EITI***

Gjatë periudhës Shtator – Nëntor 2016, Sekretariati Shqiptar EITI zhvilloi për të tretin vit radhazi Anketën EITI. Ky anketim u zhvillua në kuadër të hartimit të një Strategjie Komunikimi sa më efikase dhe mbi marrjen e të dhënave statistikore rreth impaktit EITI në komunitet. Pyetësori konsistoi në 21 pyetje, për të prodhuar të dhëna se sa njohuri kanë qytetarët e Shqipërisë rreth industrisë nxjerrëse, Nismës EITI dhe investimeve në komunitetin e tyre nga të ardhurat që sjell kjo industri në arkën e buxhetit të shtetit. Anketimi u zhvillua në qytetet Burrel, Krastë, Bulqizë, Patos, Fier, Vlorë, Selenicë, Librazhd, Përrenjas, Pogradec, Rrëshen, Kukës, Vau Dejës dhe Tiranë. Në secilën zonë u anketuan 100 qytetarë. Ashtu si edhe dy vite më parë, pyetjes "Se çfarë burimesh natyrore ka/shfrytëzohet në Shqipëri/qytetin/zonën tuaj?", rezultoi se 95% e të anketuarve ishin në dijeni të ushtrimit të aktivitetit nxjerrës në komunitet por besimi te qytetarët se kjo industri shfrytëzohet për

zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të komuniteteve është shumë i ulët. Duke parë dhe një përqindje të ulët të përgjigjeve pozitive rreth pyetjes "EITI është Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse. Keni dëgjuar ndonjëherë për të?", na nxit të vijojmë fushatën promovuese më intensivisht në zonat ku operon industria nxjerrëse. Anketimi zgjati deri në fillim të muajit Nëntori 2016 dhe shërbeu edhe si një mjet promovimi i Nismës EITI, ku stafi i Sekretariatit Shqiptar EITI zhvilloi takime me përfaqësues të të gjitha bashkive dhe ku u fol rreth implementimit të Nismës EITI në Shqipëri, publikimit të raporteve vjetore EITI, si dhe rreth problematikave që hasin këto bashki në mbledhjen dhe rakordimin e të ardhurave në përgjithësi apo nga renta minerare në veçanti që krijohen dhe shpërndahen për tu përdorur për komunitetin.

Objektivi 11 *Projekte shtesë*

Nuk ka filluar

Objektivi 12 *Zgjerimi i kapaciteteve EITI*

- Duke e vlerësuar rëndësinë e zgjerimit të kapaciteteve, për vitin 2016 punonjësit e Sekretariatit përfituan trajnime si Prokurimi Publik organizuar nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) dhe Inspektorë të Jashtëm për Inspektimin Financiar Publik organizuar nga Ministria e Financave.
- Përfaqësues të Misionit të Bankës Botërore zhvilluan një trajnim në Tiranë më datë 9 qershor 2016 për anëtarët e MSG, stafin e Sekretariatit Shqiptar EITI si dhe përfaqësuesve të institucioneve shtetërore pjesë e proçesit EITI. Gjatë prezantimit u theksua dhe u vlerësua progresi i Shqipërisë në zbatimin e Standartit EITI si dhe u diskutuan sfidat e mëtejshme dhe aktivitetet që do kontribuojnë në implementimin efektiv të reformave në industrinë nxjerrëse. Mund të shtojmë këtu, ftesën që EITI i ka bërë antarëve të MSG për aplikim në trajnimet e ofruara nga Columbia University, ku pesë persona do të përzgjidhen për të realizuar këtë trajnim gjatë vitit 2017.
- Po me këtë objektiv, në 6 Shtator 2016 Administratori i Pavarur Deloitte Audit Albania dhe Sekretariati EITI Shqipëri, zhvilluan një sesion i plotë trajnimi dhe informimi te të gjitha kompanitë raportuese në EITI mbi Pronarët Përfitues (Beneficial Owners) dhe kërkesat e ardhëshme të raportimit të detyruar për BO në 2020. U dhanë definicione të plota mbi atë se cilët quhen BO dhe u pajisën me një formular sqarues.

- Sipas Programit Kombëtar të Praktikave të Punës dhe Vendimit të Kryeministrit Nr. 395 datë 29.04.2015, për "Miratimin e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës në Administratën Shtetërore dhe institucionet e tjera publike", Sekretariati Kombëtar Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI Shqipëri), publikoi njoftimin për dy aplikantë të profilit studentor: Hidroteknik dhe Financë/Kontabilitet dhe pranoi për të dytin viti rradhazi një aplikant. Në përfundim të praktikës, aplikantit iu ofrua një kontratë pune një vjeçare me EITI Albania.
- Në Dhjetor 2015, EITI Albania solli për palët e interesit trajnime te personalizuara mbi Mireqeverisjen e Burimeve Natyrore nga Columbia University dhe Earth Institute NY. Ne organzuam trajnime per Gazetaret, Parlamentaret, Akademiket, MSG dhe të interesuar të tjerë mbi: paketat fiskale, kuadri ligjor, mbrojtja e ambjentit, impakti ekonomik etj. Nën kujdesin dhe mbështetjen programatike të EITI për ngritjen e kapaciteteve në adminsitrimin e burimeve natyrore, Drejtoria ligjore e Ministrise së Energjisë e cila ballafaqohet fort me mosmarrëveshjet që lindin mes paleve në ekzekutimin e kontratave koncesionare, dergoi për trajnim më të thelluar përfaqesuesit e vet në trajnimin e specializuar mbi Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe Arbitrazhin Ndërkombëtar ofruar nga Columbia University, NY. Në këtë kuadër, EITI Albania ka filluar koordinimin përgjatë Dhjetor 2016 me Columbia University dhe Houston University që në kuadër të trajnimit të vazhdueshëm dhe cilësor të kuadrove, të dërgojë për trajnime më të thelluara 8 përfaqesues të tjerë nga rrjeti EITI shqiptar në 2017. Përfaqesues të Minsitrisë së Financave, Drejtorisë të Taksave, Drejtorisë Hidrokarbure dhe EITI do të jetë pjesë e trupës që do të ndjeki trajnimet në vazhdim.

Vlerësimi i performancës kundrejt kërkesave EITI

Bazuar mbi kërkesat e Standartit EITI, Raporti EITI 2015, është përfshirë informacioni kontekstual mbi sektorin e nxjerrës dhe atë të hidroenergjisë, si dhe pagesat nga të gjitha shoqëritë e liçensuara, të përzgjedhura që vepronin në prodhimin e kërkimin e naftës, gazit, hidroenergjisë dhe mineraleve; të gjitha shoqëritë e liçensuara që vepronin në prodhimin e naftës dhe gazit, hidroenergjisë si dhe prodhuesit më të mëdhenj në sektorin minerar. Institucioneve qeveritare ju kërkua të raportonin të ardhurat që kanë arkëtuar nga këto shoqëri. Subjektet e përfshira në deklarimin e pagesave të kryera për shtetin në Raportin e vitit 2015 zënë në sektorin e naftës dhe të gazit 100%, në sektorin e hidroenergjisë 95% dhe në sektorin minerar 88% të prodhimit.

Vlerësimi i performancës kundrejt kërkesave EITI

Kërkesa	Progresi
1. Kërkesa EITI 5.3 ***Menaxhimi i të ardhurave dhe shpenzimeve*** *Grupi ndërinstitucional i punës ka për detyrë të bëjë publike çdo informacion të mëtejshëm në lidhje me menaxhimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, përfshirë: a) Një përshkrim të të gjitha të ardhurave nga industria nxjerrëse të alokuara për rajone gjeografike ose programe të caktuara. Ai duhet të përmbajë një përshkrim të metodave që garantojnë llogaridhënie*	*Të ardhurat e mbledhura nga Buxhti Shtetit nga industria nxjerrëse bashkohen me të ardhurat e tjera në buxhet dhe alokohen natyrshëm nëpër zërat e buxhetit. Nuk ka alokim specifik të këtyre të ardhurave në progarme të buxhetit. Njëkohësisht këto të ardhura përbëjnë rreth 3% të Buxhetit.* *AKBN menaxhon vetë një pjesë të të ardhurave nga Marrëveshjet Hidrokarbure. Deri tani AKBN nuk ka dhënë informacion se si alokohen këto të ardhura në buxhetin e saj.* *Shteti shqiptar mbledh të ardhura nga sektori i naftës dhe gazit nëpërmjet ndarjes së prodhimit të naftës, bonuset, rentën minerare, tatimit mbi fitimin dhe të ardhurave nga investimet direkte në sektor. Në raport tregohet shpërndarja e të ardhurave totale të gjeneruara nga operacionet e naftës midis Qeverisë Shqiptare, shoqërisë Albpetrol, AKBN-së dhe shoqërive private të naftës. Interesi*

dhe eficencë në përdorimin e tyre. b) Një përshkrim të buxhetit të vendit dhe proçeseve të auditimit si dhe linket ku mund të gjenden informacione të disponueshme publikisht për buxhetin, shpenzimet dhe raportet e auditimit. c) Të dhëna në kohën e duhur nga ana e qeverisë të cilat do të nxisin më tej ndërgjegjësimin dhe debatin rreth çështjeve të tilla si qëndrueshmëria e të ardhurave dhe varësia nga burimet. Këtu mund të bëjnë pjesë pritshmëritë për vitet e ardhshme në ciklin e buxhetit në lidhje me prodhimin e projektuar, çmimet e mallrave dhe parashikimet e të ardhurave nga industritë nxjerrëse si dhe përqindja e të ardhurave fiskale që pritet të vijnë nga sektori nxjerrës.	*i Shtetit Shqiptar në PSA administrohet nga Albpetrol dhe AKBN, të cilat marrin nga PSA-të: bonuse, pjesë nga prodhimi i naftës dhe të ardhurave të tjera nga rrjedhin nga mos-zbatimi i termave të kontratave si gjoba dhe garanci të ekzekutuara.* *MEI publikon informacion financiar lidhur me shpenzimet sipas natyrës dhe programit në faqen e saj të internetit:* *http://www.energjia.gov.al/al/publikime/trasparence-per-publikun/te-dhena-financiare-te-mei.*
2. Kërkesa EITI 4.4 ***Të ardhurat nga transporti*** *Të ardhurat e marra nga transporti i naftës, gazit dhe mineraleve kur këto përbëjnë zërat më të mëdha të të ardhurave në sektorin nxjerrës. Të dhënat e publikuara duhet të ndahen në nivel të barabartë me e zërat e të ardhurave dhe pagesave të tjera të raportuara (Kërkesa 4.7.). Vendet implementuese duhet të deklarojnë:* *i. Një përshkrim të marrëveshjeve të transportit, përfshirë: produktin, itinerarin e*	*Shteti Shqiptar nuk merr taksë tranziti. Tubacionet e Albpetrol nuk janë funksionale.* *Dy tubacione për transportin e naftës së papërpunuar lidhin terminalin e naftës së ARMOs në Vlorë me rafineritë e Fierit dhe Ballshit si dhe dy rafineritë mes tyre. Të dy tubacionet janë jashtë funksionit për shkak të vjetërimit. Në total, rrjeti i tubacioneve të naftës ka një gjatësi prej 188 km dhe kapacitet prej 2.5 milion ton në vit.* *Trans Adriatic Pipeline (TAP) AG është një bashkim i disa shoqërive themeluar me qëllimin planifikimin, zhvillimin dhe ndërtimin e gazsjellësit natyror TAP. Sipas MEI-t, në përputhje me rregullat e Bashkimit Evropian për tranzitin e lirë të gazit, marrëveshja nuk parashikon tarifë për tranzitin e gazit.*

transportit; kompanitë përkatëse dhe subjektet qeveritare, së bashku me NSH-të e përfshira në transport. ii. Përcaktimet e taksave, tarifave ose pagesave të tjera të rëndësishme të transportit, si dhe metodologjitë e përdorura për llogaritjen e tyre. iii. Publikimin e tarifave dhe vëllimit të mallrave të transportuar. iv. Deklarimin e të ardhurave të marra nga subjektet qeveritare, NSH-të, lidhur me transportin e naftës, gazit dhe mineraleve. 29 v. Grupi i punës inkurajohet, kur kjo gjë është e mundur, të ngarkojë Administratorin e Pavarur me detyrën e rakordimit të pagesave dhe të të ardhurave materiale që lidhen me transportin e naftës, gazit dhe mineraleve.	
3. Kërkesa EITI 6.1 ***Shpenzimet e kompanive nxjerrëse për qëllime sociale*** *a) Në rastet kur shpenzimet e kompanive për qëllime sociale janë të përcaktuara me ligj apo nga kontrata me qeverinë e cila rregullon investimet nxjerrëse, kërkohet që vendet zbatuese të bëjnë deklarimin dhe, kur është e mundur, rakordimin e transaksioneve të tilla. Kur këto përfitime ofrohen në natyrë, është e nevojshme që vendet zbatuese të deklarojnë natyrën dhe*	*Minsitria e Energjise dhe Industrise, konfirmon që nuk ka pagesa të tilla në marrëveshjet hidrokarbure, koçensionet minerare dhe hidroenergjetike.* *EITI dhe Administratori i pavarur nuk kanë pasur akses tek këto marrëveshje për arsye të klauzolës së konfidencialitetit.* *Gjithashtu, edhe vetë shoqëritë nuk kanë raportuar shuma materiale përgjatë proçesit të reportimit, ose kanë raportuar kosto të ndërmarra me iniciativën e tyre, por jo për shkak të detyrimeve.* *Disa shpenzime kontraktuale janë parashikuar në Marrëveshjen me TAP.* *Në vijim do ishte mirë që të diskutohet aksesi në këto marrëveshje për të bërë një analize të pagesave të tjera që ndodhen në marrëveshje dhe mund të kenë natyrën e shpenzimeve sociale.*

vlerën e gjykuar të transaksionit në natyrë. Në rast se përfituesi i shpenzimeve sociale është një palë e tretë, dmth një agjenci joqeveritare, kërkohet që të bëhet publike emri dhe funksioni i përfituesit. Kur rakordimi nuk është i mundshëm, vëndet duhet të paraqesin deklarata të njëanshme të këtyre transaksioneve nga kompanitë dhe/ose qeveria. b) Në rast se grupi ndërinstitucional i punës bie dakord se shpenzimet dhe transfertat sociale diskrecionale kanë natyrë materiale, grupi i punës duhet të krijojë një proces raportimi që synon arritjen e transparences në përputhje me pagesat dhe të hyrat e tjera për subjektet qeveritare. Në rastet kur rakordimi i transaksioneve kyçe nuk është i mundur, psh, kur pagesat e kompanive janë në natyrë ose ndaj një pale të tretë joqeveritare, grupi i punës mund të bjerë dakord për deklarim vullnetar e të njëanshëm nga ana e kompanive dhe /ose qeveria.	
4. Kërkesa EITI 5.2 ***Transfertat lokale*** *a) Kur transfertat ndërmjet njësive të qeverisë*	*Ministria e Financave është në proçes përmirësimi të proçedurave në mënyrë që të sigurohet për saktësinë dhe plotësinë e shpërndarjes së rentës në përputhje me kërkesat e reja ligjore. Sipas ndryshimeve të propozuara, gjatë vitit 2015 NJQV-të do të kenë të drejtë të marrin 5%*

qëndrore dhe lokale lidhen me të ardhurat e gjeneruara nga industria nxjerrëse dhe janë të përcaktuara nga kushtetuta, statuti apo mekanizma të tjera për shpërndarjen e të ardhurave, grupi i punës duhet të sigurojë deklarimin e transfertave materiale. Vendet zbatuese duhet të bëjnë gjithashtu të njohur edhe formulën e shpërndarjes së të ardhurave, në rast se ka, si dhe çdo mospërputhje ndërmjet shumës së transfertës të llogaritur sipas formulës përkatëse për shpërndarjen e të ardhurave dhe shumës aktuale të transferuar midis njësive të pushtetit qendror dhe atij lokal. Grupi i punës ka për detyrë të kryejë rakordimin e këtyre transfertave. Në rast se ekzistojnë barriera kushtetuese ose thelbësore ndaj pjesëmarrjes së njësive të qeverisë lokale, grupi i punës mund të kërkojë zbatim të përshtatur në përputhje me Kërkesën 8.1. b) Grupi i punës duhet të garantojë deklarimin, dhe nëse është e mundur rakordimin, e të gjitha transfertave materiale diskrecionare ose ad-hoc.	*të rentës minerare të gjeneruara nga Shoqëritë që prodhojnë në zonën e tyre pa marrë parasysh ndonjë transferim të parashikuar në përputhje me ligjin e buxhetit vjetor. Udhëzim Nr.26, datë 4.9.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar përcakton procedurat rakorduese për alokimin e rentës minerar. Sipas këtij udhëzimi, NJQV-të në duhet të kryejnë rakordimet me drejtoritë rajonale të tatimeve dhe doganave në fund të cdo muaji dhe të nisin këto rakordime pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave. Njëkohësisht drejtoritë rajonale të tatimeve dhe doganave duhet të dergojnë brenda muajit informacion analitik për rentën e mbledhur dhe NJQV-të përfituese. Mbi bazën e rakordimeve Ministria e financave kryen transfertat e rentës NJQV-ve përfituese në muajin pasardhës.* *Për shoqëritë e naftës, veprimtaria e të cilave shtrihet në disa NJQV njëkohësisht, udhëzimi përcakton përqindjen e rentës që do t'i shkojë çdo NJQV-je në varësi të vendburimit ku është prodhuar nafta apo gazi i shitur.*

5. Kërkesa EITI 2.5 ***Pronarët përfitues*** *a). Rekomandohet që vendet zbatuese të mbajnë një regjistër publik të pronarëve përfitues të korporatave që marrin pjesë në tender, operojnë apo investojnë në asete të industrisë nxjerrëse, përfshirë identitetin e tyre, nivelin e pronësisë si dhe të dhënat mbi ushtrimin e kontrollit ose të pronësisë. Në rastet kur është e mundur, ky informacion duhet të përfshihet edhe në dokumentet ekzistuese që kompanitë kanë depozituar pranë autoriteteve rregullatore të korporatave, në bursë apo tek agjencitë e lincecimit. Në rastet kur ky informacion është aktualisht i disponueshëm publikisht, Raporti EITI duhet të përmbajë udhëzime për mënyrën e aksesit në të. b) Është e nevojshme që: i. Raporti EITI të përmbajë informacion mbi politikat e qeverisë dhe diskutimet e MSG -së në lidhje me deklarimin e pronarëve përfitues. Këtu duhet të përfshihen detaje mbi dispozitat ligjore përkatëse, praktikat aktuale të deklarimit si dhe të gjitha reformat e parashikuara apo në proces lidhur me deklarimin e pronësisë. ii.*	*Në kontekstin e legjislacionit shqiptar "Pronar përfitues"[1] perkufizohet ne Ligji nr.9917, datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i ndryshuar, neni 2 / pika 12. si personi fizik, që zotëron ose kontrollon i fundit një klient dhe/ose personi, për llogari të të cilit kryhet një transaksion. Këtu përfshihen edhe ata persona, të cilët ushtrojnë kontrollin e fundit efektiv ndaj një personi juridik. Kontroll i fundit efektiv është marrëdhënia, në të cilën një person:* *a) zotëron në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të paktën 25 për qind të aksioneve ose të votave të një personi juridik;* *b) i vetëm zotëron të paktën 25 për qind të votave të një personi juridik në bazë të një marrëveshjeje me ortakët ose me aksionarët e tjerë;* *c) përcakton de facto vendimet e marra nga personi juridik;* *d) kontrollon në çdo lloj mënyre zgjedhjen, emërimin dhe largimin e shumicës së administratorëve të personit juridik.* *Ky ligj përkufizon gjithashtu "Personat e ekspozuar politikisht" si personat, të cilët janë të detyruar të bëjnë deklarimin e pasurive të tyre, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", përfshirë anëtarët e familjes apo personat e lidhur në marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi, me përjashtim të nëpunësve të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues, sipas përcaktimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Në këtë kategori përfshihen edhe individët, të cilët kanë pasur ose kanë funksione të rëndësishme në një qeveri dhe/ose në një shtet të huaj, si: kryetar shteti dhe/ose qeverie, politikanë të lartë, zyrtarë të lartë të qeverisë, të gjykatave ose të ushtrisë, drejtues të lartë të kompanive shtetërore, zyrtarë të rëndësishëm të partive politike, përfshirë anëtarët e familjes apo personat e lidhur në marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi."*

Që prej 1 Janarit, 2017, grupi i punës ka nisur publikimin e një udhërrëfyesi lidhur me deklarimin e pronësisë në përputhje me klauzolat (c) - (f) më poshtë. Në udhërrëfyes do të përcaktohen të gjitha piketat kryesore dhe afatet, ndërkohë që zbatimi i tij do të jetë objekt vlerësimi nga ana e MSG-së si pjesë e raportit të saj vjetor. *c) Prej1 Janarit, 2020, duhet që vendet zbatuese të kërkojnë, dhe kompanitë të deklarojnë, informacione në lidhje me pronësinë që do të përfshihen në raportin EITI. Kjo vlen për ato korporata që marrin pjesë në tendera, operojnë apo investojnë në asete të industrisë nxjerrëse dhe ky informacion duhet duhet të përfshijë identitetin e pronarit (pronarëve), nivelin e pronësisë si dhe detaje mbi ushtrimin e kontrollit ose të pronësisë. Çdo mangësi apo e metë në raportimin e informacionit mbi pronësinë e përfituesve duhet të deklarohet në Raportin EITI, sëbashku me emrat e subjekteve që nuk arritën të dorëzonin të gjithë ose një pjesë këtij informacioni. Në rast se ndonjë prej vendeve do të jetë duke u përballur me barriera kushtetuese ose thelbësore për zbatimin e kësaj kërkese në 1 Janar 2020, atëherë ky vend*	*Në kuadrin e përpilimit të raportit EITI 2015, MSG i kërkoji subjekteve raportuese dhe autoritetit kontarktues, MEI-it të raportojë informacion për pronarët e dobishëm sipas perkufizimeve të standartit EITI. MEI konfirmon se sot Ministria nuk disponon një regjistër sipas kërkesave të standartit EITI. Subjektet e licensuara gjithashtu nuk ishin gati për këtë raportim. Shumica e subjekteve zgjodhi të mos e plotësoj formularin duke komentuar se pronësia mbi shoqerinë paraqitej në regjistrin e QKR. Një pjesë e mirë e tyre u shprehën se nuk kishte detaje të zinxhirit të plotë të pronësisë. Vetëm 17 raportuan pronarët e shoqërisë. Në të gjitha rastet pronarët e listuar ishin të njëjtë me çfarë ishte paraqitur në qëndrën kombëtare të regjistrimit.*

mund të kërkojë zbatim të përshtatur në përputhje me Kërkesën 8.1. d) Informacioni lidhur me identitetin e pronarit përfitues duhet të përmbajë emrin e tij, kombësinë dhe vendbanimin, si dhe identifikimin e personave të ekspozuar politikisht. Gjithashtu rekomandohet deklarimi i numrit të kartës së identitetit, datëlindja, adresa e banimit apo shërbimit, si dhe mënyrat e kontaktit. e) Grupi i punës duhet të miratojë një qasje që garanton saktësinë e informacionit të paraqitur nga kompanitë pjesëmarrëse. Kjo mund të kërkojë që kompanitë të vërtetojnë deklaratën e pronësisë përmes nënshkrimit nga një drejtues i nivelit të lartë apo këshilltar i lartë ligjor, ose të dorëzojnë dokumentacion mbështetës. *f) Përkufizimi i pronarit përfitues: i. Pronar përfitues në lidhje me një kompani do të thotë personi (at) fizik i cili direkt ose indirekt zotëron ose kontrollon korporatën.* *ii. Grupi i punës duhet të bjerë dakord në lidhje me përkufizimin e duhur të termit pronar përfitues. Përkufizimi duhet të jetë në linjë me pikat (f) dhe (i) më sipër si dhe të marrë në konsideratë normat*	

ndërkombëtare dhe ligjet kombëtare përkatëse, si dhe duhet të përfshijë pragun e pronësisë (s). Përkufizimi duhet të përcaktojë detyrimet për raportim për personat e ekspozuar politikisht. iii. Kompanitë e listuara publikisht, përfshirë filialet në pronësi të plotë, duhet të bëjnë të ditur emrin e burses si dhe linkun e bursës ku ato janë të listuara. iv. Në rastin e ndërmarrjeve të përbashkëta (joint ventures), secili prej subjekteve pjesëmarrës duhet të deklarojë pronarin (ët) e tij, përveç rasteve kur subjektet janë të listuara publikisht ose janë filiale në pronësi të plotë të një kompanie të listuar publikisht. Secili subjekt është përgjegjës për saktësinë e informacionit të ofruar. g) Raporti EITI duhet të përmbajë gjithashtu informacion mbi pjesën e pronësisë së këtyre kompanive.	
6. Kërkesa EITI 2.4 ***Kontratat*** *a) Vëndet zbatuese duhet të bëjnë publike të gjitha kontratat dhe licencat që përmbajnë kushtet për shfrytëzimin e naftës, gazit dhe mineraleve.*	*Kontratat nuk bëhen publike për arsye konfidencialiteti. Draft ligji për EITI propozon bërjen publike të kontratave.Të gjitha kontratat e koncensionit janë firmosur nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë në kapacitetin e autoritetit kontraktues nga Këshilli i Ministrave. Pas nënshkrimit të kontratës, operatori harton planin e detajuar të zbatimit. Përpara miratimit, ky plan i nënshtrohet përsëri oponencës teknike shtetërore. Ndërtimi i hidrocentraleve energjetike*

b) Është e nevojshme që Raporti EITI të përmbajë informacion mbi politikat e qeverisë në lidhje me bërjen publike të kontratave dhe licencave që rregullojnë kërkimin dhe shfrytëzimin e naftës, gazit dhe mineraleve. Këtu duhet të përfshihen detaje mbi dispozitat ligjore përkatëse, praktikat aktuale të deklarimit si dhe të gjitha reformat e parashikuara apo në proces. *Kur është e zbatueshme, Raporti EITI duhet të ofrojë një pasqyrë të kontratave dhe licencave që janë publikisht të disponueshme, si dhe të përmbajë një referencë ose linkun ku ato janë publikuar. c) Termi kontratë në 2.4 (a) do të thotë: i. Teksti i plotë i çdo kontrate, koncesioni, marrëveshje për ndarje prodhimi apo cdo marrëveshje tjetër të lidhur nga ana e qeverisë, e cila përmban kushtet lidhur me shfrytëzimin e gazit, naftës dhe rezervave minerare. ii. Teksti i plotë i çdo aneksi, shtojce ose pike i cili përcakton detajet lidhur me të drejtat e shfrytëzimit të përshkruara në 2.4 (c) (i) ose ekzekutimin e tyre. iii. Teksti i plotë i çdo ndryshimi ose amendamenti në dokumentet e përshkruara në 2.4 (c) (i) dhe 2.4 (c) (ii). d) Termi licencë në 2.4 (a) do të thotë: i. Teksti i plotë i çdo licence, kontratë*	*është subjekt i 10 deri në 20 lejeve dhe lejeve nga organe të ndryshme rregullatore, duke përfshirë: lejen mjedisore (vjetore), lejet për ndërtimin (para ndërtimit), leje për përdorimin e burimeve ujore (vjetore), licensë për prodhimin e energjisë (para fillimit të prodhimit), lejen për lidhjen me rrjetin e transmetimit etj.*

qiraje, titulli apo leje përmes së cilës qeveria i jep kompanisë (ve) ose individit (individëve) të drejta për shfrytëzimin e naftës, gazit dhe/ose burimet minerare. ii. Teksti i plotë i çdo aneksi, shtojce ose pike që përcakton detajet lidhur me të drejtat e shfrytëzimit të përshkruara në 2.4 (d) (i) ose ekzekutimin e tyre. ii. Teksti i plotë i çdo ndryshimi ose amendamenti në dokumentet e përshkruara në 2.4 (d) (i) dhe 2.4 (d) (ii).	

Linqe mbi impaktin në 2016

http://www.lapsi.al/lajme/2016/02/10/dokumenti-afera-100-milion%C3%AB-usd-albpetrol-manipuloi-2-tenderat-e-shitjes-s%C3%AB-naft%C3%ABs#.WKRN2vWcEdU

http://shqiptarja.com/m/ekonomi/kush-fshihet-pas-shitjes-me-t--lir--t--naft-s-nga-albpetroli--341437.html

http://opinion.al/berisha-mega-afera-me-naften-e-albpetrol-te-perfshire-kokedhima-e-gjiknuri/

https://www.youtube.com/watch?v=53EzMlr5VDk

http://www.balkanweb.com/site/gjiknuri-ne-konferencen-e-eiti-t-ne-peru-transparence-per-shfrytezimin-e-burimeve-natyrore/

http://kfos.org/kfos-vazhdon-me-eiti/

http://www.monitor.al/raporti-klsh-ja-masakra-qe-eshte-bere-shfrytezimin-e-naftes-ne-shqiperi/

http://www.rd.al/2017/01/masakra-shqiptare-me-shfrytezimin-e-naftes/

http://gazeta-shqip.com/lajme/2016/02/27/minierat-gjiknuri-do-te-tregojme-pronaret-e-vertete/

http://www.shell.al/qendrueshmeria/transparenca.html

http://project-balcanosh.net/2016/09/28/raport-i-takimit-te-pare-ne-shqiperi-mbajtur-ne-tirane-ne-27-shtator-2016/

http://pergasje.com/2016/02/koncesionet-sa-pak-te-ardhura-dhe-te-punesuar-nga-shitja-e-vendit/

http://www.javanews.al/gjiknuri-rinegociojme-kontraten-me-bankers-petroleum/

Përmbledhje e përgjigjeve të MSG për rekomandimet nga rakordimi dhe validimi, nëse është e aplikueshme

Rekomandimet e Raportit EITI 2015 janë diskutuar në MSG si më poshtë:

Rakordimi 1 *Vonesat dhe mospërputhjet*

Në mënyrë që të lehtësohet proçesi i rakordimit dhe përpilimi i raportit, Administratori i Pavarur, Deloitte Audit Albania sugjeron që të përcaktohet një kalendar vjetor për kryerjen e procesit të raportimit dhe rakordimit. Afati vjetor për raportim duhet të planifikohet në kohë dhe të përfshihet në kalendarin vjetor të raportimit të shoqërive. Për këtë arsye, përzgjedhja e shoqërive raportuese dhe kërkesave për raportim duhet të planifikohet dhe të komunikohet disa muaj përpara afatit për dorëzimin e raportimit. Gjithashtu, me qëllim që të zvogëlohet numri i mospërputhjeve me pagesat e raportuara nga autoritetet tatimeve, MSG mund t'i kërkojë shoqërive raportuese që të krahasojnë shumën e pagesave të kryera ndaj tatimeve gjatë vitit në raportim me degët rajonale të tatimeve përpara se t'i raportojnë këto pagesave për rakordimin EITI. Ministria duhet të ndjekë zbatimin rigoroz të legjislacionit shqiptar në fuqi lidhur me raportimin financiar dhe auditimin e pasqyrave financiare të shoqërive në sektorin nxjerrës dhe atë të hidroenergjisë. Kjo do të sjellë përmirësim të cilësisë dhe sasisë së informacionit financiar prodhuar për aktivitetet nxjerrëse në Shqipëri.

MSG e sheh me interes këtë propozim. EITI Albania u dergoi të gjitha Institucioneve përgjegjëse të përfshira në raportim rekomandimet e Adminsitratorit te Pavarur në mënyrë që të fillojë marrja e masave për implementim. Megjithatë, si institucionet shteterore përgjegjëse në raportim ashtu edhe operatorët hezitojnë të fillojnë implementimin e nismave të caktuara për sa kohë nuk përfshihen dhe rregullohen në instruksione qeveritare, nëpermjet ligjeve apo VKM-ve.

Për këtë arsye, EITI Albania inicioni me miratimin e MSG analizen e kuadrit ligjor në mbështetje të EITI dhe propozimin e përmiresimeve përkatëse që do të mundësojnë implementimin e rekomandimeve.

Rakordimi 2 ***Proçedurat Verifikuese***

Në kontekstin e përmirësimit të cilësisë të raportimit të Shoqërive dhe njëkohësisht për të marrë siguri mbi informacionin e raportuar, Administratori i Pavarur, Deloitte Audit Albania rekomandon që Ministria t'ju kërkojë shoqërive të liçensuara të paraqesin pagesat dhe informacione shtesë sipas standardit EITI në një raport të veçantë ose në një aneks të pasqyrave financiare vjetore. Në të dy rastet ky informacion duhet të jetë subjek i auditimit të pavaruar vjetor.

Ky rekomandim ka patur diskutime dhe ka ngjallur rezistencë veçanërisht nga operatorët e përfshirë në raportim, për shkak të kostove shtesë që sjell auditimi i pasqyrave të dedikuara për EITI.

Rakordimi 3 ***Aspekte të tjera cilësore të analizës së pagesave***

Administratori i Pavarur, Deloitte Audit Albania rekomandon që MEI të rrisë kërkesat rregullatore për të siguruar raportimin e pagesave dhe taksave për secilën licensë më vete. Nëpërmjet krahasimit të pagesave për çdo licensë me nivelin e prodhimit dhe tatimit, MEI mund të përftojë një bazë të mjaftueshme të dhënash për buxhetimin e të ardhurave dhe analizën e efektivitetit të politikave fiskale në periudhë afatmesme dhe afatgjatë.

Ky rekomandim i është përcjellë zyrtarisht MEI nga ana e EITI Albania. Përsëri, ky rekomandim vjen si nevojë për të përmirësuar kuadrin ligjor dhe rregullativ në harmoni të plotë me kornizën ekzistuese për industrinë.

Rakordimi 4 ***Mangësit e raportimit të konsoliduar në qeverisjen qëndrore dhe vendore***

Për të përmirësuar kohën, kostot dhe cilësinë e raportimit nga Qeveria, Administratori i Pavarur, Deloitte Audit Albania rekomandon:

- Bashkëpunimin me ekipin e raportimit të Qeverisë për të krijuar raporte që mund të prodhohen nga sistemi i Thesarit me informacion për pagesat e mbledhura për çdo

taksapagues sipas llojit të taksave. Për disa arsye shpjeguar më poshtë, se qasja në raportet e prodhuar nga sistemet e informacionit të Qeverisjes Qëndrore do të ishte zgjidhja më e mirë.

○ Megjithatë, nëse kjo nuk mund të realizohet në një periudhë afatshkurtër apo afatmesme, Deloitte Audit Albania rekomandon vlerësimin e mundësisë për të marrë këtë informacion nga sistemet e informacionit të agjencive qeveritare që arkëtojnë të ardhura në sektor.

Përgjatë 2016, Drejtoria e Përgjithëshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithëshme e Doganave kanë gjeneruar nga sistemet e saj, për llogari të raportit EITI të dhëna të kondensuara për industrinë.

Rakordimi 5 Raportimi i Njësive të Qeverisjes Vendore

Pika 3 e nenit 9-të të Ligjit Nr. 7746, datë 28.7.1993, "Për hidrokarburet (kërkim dhe prodhim)", i ndryshuar, kërkon zbatimin e kërkesave për raportimin në kuadër të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI) nga të gjithë kontraktorët që kanë lidhur marrëveshje hidrokarbure, organet e administratës tatimore dhe doganore, si dhe organet e qeverisjes qëndrore dhe vendore dhe I jep të drejtën Sekretariatit EITI në Shqipëri të publikopjë të dhënat në raport.

NJQV-të kanë autonomi të caktuar në bashkëpunimin me biznesin dhe tatimin e aktivitetit në zonat nën administrim. Për të përmirësuar transparencën e këtij bashkëpunimi në aspektin e pagesave të tatimeve dhe taksave lokale, tarifave për shërbimet, kontributet dhe aktivitetet në dobi të komunitetit lokal, etj. Administratori i Pavarur, Deloitte Audit Albania rekomandon studimin dhe përshtatjen e legjislacionit dhe akteve rregullative për të integruar kërkesat për raportim si pjesë e detyrave të NJQV-ve prodhuese si dhe për të adresuar ndonjë konflikt midis kërkesave për raportim dhe ligjeve dhe akteve rregullative të tjera që qeverisin aktivitetin e NJQV-ve. Aktet rregullative duhet të lejojnë fleksibilitet për përshtatjen e vazhdueshme me kërkesat dhe afatet e standartit. Shqiperia eshte ne implementim ten je reforme te forte adminsitrativo – territoriale. Viti 2014 shënoi një pikë kthese historike në organizimin administrativo-territorial të Shqipërisë. Më 31 korrik 2014, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive

të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë". Qeveria shqiptare hartoi me sukses dhe po zbaton reformën administrative-territoriale duke organizuar qeverisjen vendore në 61 bashki. Organizimi i ri territorial synon fuqizimin e bashkive duke rritur kapacitetin e tyre për të ofruar shërbime të një cilësie të lartë për qytetarët dhe duke rritur efiçencën e menaxhimit të burimeve të tyre. Reforma administrative-teritoriale do të çojë në përmirësimin e mirëqeverisjes dhe ofrimit të shërbimeve publike më efiçente nga qeveritë vendore; mbledhjen më efektive të taksave dhe tarifave nga to; mundësi më të mira për të promovuar dhe nxitur zhvillimin ekonomik lokal të qëndrueshëm.

Në këtë kuadër, ndërhyrja e MSG dhe EITI për të përmirësuar raportimin, do të bashkërendohet me Nismat qeveritare për konsolidimin e veprimtarisë së Qeverisjes Lokale.

Rakordimi 6 Raportimi i Shoqërisë Albpetrol

Ligji për hidrokarburet kërkon zbatimin e kërkesave për raportimin në kuadër të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI) nga të gjithë kontraktorët që kanë lidhur marrëveshje hidrokarbure. Panëvarësisht se nuk ka status të njëjtë me shoqëritë private të naftës, Albpetrol është palë kontraktore në të gjitha marrëveshjet hidrokarbure me objekt liçensimin e zonave nën administrimin e tij dhe si rrjedhojë duhet të interpretohet si subjekt zbatues të nenit të sipërpërmendur. Megjithatë për të adresuar konfliktet midis kërkesës për raportim dhe detyrimit të Albpetrol për konfidencialitetin e të dhënave, si dhe për të përmirësuar proçesin e bashkëpunimit, Administratori i Pavarur, Deloitte Audit Albania rekomandon studimin dhe përshtatjen e legjislacionit dhe akteve rregullative për të integruar kërkesat për raportim si pjesë e punës së vazhdueshme të Albpetrolit në sektor duke qënë shoqëri aksionere me 100% kapital shtetëror.

Për këtë arsye, EITI Albania inicioi me miratimin e MSG analizën e kuadrit ligjor në mbështetje të EITI dhe propozimin e përmirësimeve përkatëse që do të mundësojnë implementimin e rekomandimeve edhe për ndërmarrjet shtetërore.

Rakordimi 7Aksesi në raportet e prodhuara nga Sistemi i Tatimeve

Siç rekomandohet edhe më sipër në pikën 7.2.1 për të përmirësuar kohën, kostot dhe cilësinë e raportimit nga Qeveria, MSG dhe EITI Shqipëri duhet të bashkëpunojë me ekipin e

raportimit të Qeverisë për të hartuar raporte që mund të prodhohen nga sistemi i Thesarit. Megjithatë, nëse kjo nuk mund të realizohet në një periudhë afatshkurtër apo afatmesme, dhe duke konsideruar madhësinë e të ardhurave që mbledh DPT në sektor Administratori i Pavarur, Deloitte Audit Albania rekomandon vlerësimin e mundësisë për të prodhuar raporte dhe informacion nga sistemi i tatimeve duke ndarë me DPT listën e saktë të NIPT-ve që operojnë në sektorët nxjerrës dhe të hidro-energjisë.

Përgjatë 2016, Drejtoria e Përgjithëshme e Tatimeve ka gjeneruar nga sistemet e saj, për llogari të raportit EITI të dhëna të kondensuara për industrinë.

Rakordimi 8 Publikimi i stastistikave dhe fakteve mbi industrinë nxjerrëse

Për të përmirësuar plotësinë dhe saktësinë, besueshmërinë dhe aksesin në informacionin kontekstual, Administratori i Pavarur, Deloitte Audit Albania rekomandonë që Ministria e Energjisë dhe Industrisë të publikojë në mënyrë periodike (të paktën çdo vit) fakte mbi industrinë duke përfshirë: potencialin e industrisë dhe prodhimin aktual, kontributin në ekonomi, strategjinë e sektorit, ngjarje dhe fakte, rregullimin aktual dhe ndryshimet e ardhshme etj. Informacion kontekstual mund të përfshijë informacione të tjera të dobishme për statistikat e sektorit të tilla si:

- Madhësia e prodhimit dhe detaje të cilësisë (graviteti i naftës, përqendrimi i mineraleve, etj),
- Investimet (numri i puseve dhe galerive të minierave nën administrim / zhvillim),
- Projektet për rehabilitimin mjedisor dhe kostot përkatëse,
- Fuqia punëtore e punësuar, paga mesatare dhe nënkontraktimi, shpenzimet sociale, etj.

Këto informacione mund të mblidhen e të përpunohen çdo vit dhe të shërbejnë si bazë për raportimin e statistikave dhe fakteve për industrinë. AKBN, si institucion i angazhuar gjerësisht në monitorimin e sektorit mund të kontribuojë në përpilimin e informacionit kontekstual nëpërmjet grumbullimit të informacionit nga raportimet vjetore të shoqërive për çdo licensë në AKBN bazuar në treguesit e përcaktuar nga MSG për prodhimin, rezervat, shitjen, numrin e punonjësve, investimet në mjedis, pagesat sociale etj. Ndër të tjera, përmes përdorimit të treguesve, AKBN mund të përmbledh fakte të bazuara në studimet vjetore të mjedisit duke theksuar rreziqet dhe trendet në nivel vendi, si dhe zona të veçanta ku përqendrohet veprimtaria e operatorëve në sektorin e nxjerrjes dhe të energjisë. Në kuadër të përmirësimit të raportimit dhe statistikave në industrinë nxjerrëse, Deloitte Audit

Albania rekomandonë Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë të shqyrtojë nëse do të zbatojë kërkesat e raportimit të ngjashme si në Direktivat e BE-së për Kontabilitetin dhe Transparencën.

Ky rekomandim i është përcjellë për zbatim të gjitha agjensive shtetërore të përfshira në EITI, por për sa kohë këto kërkesa nuk janë parashikuar me ligj apo akte qeveritare implementimi i tyre has pengesa nga më banalet. Për këtë arsye, EITI Albania inicioji me miratimin e MSG analizën e kuadrit ligjor në mbështetje të EITI dhe propozimin e përmirësimeve përkatëse që do të mundësojnë implementimin e rekomandimeve sa më sipër.

Rakordimi 9 Të dhënat për sasinë dhe vlerësimin e prodhimit

Administratori i Pavarur, Deloitte Audit Albania rekomandon që AKBN të kryej matje të prodhimit minerar të nxjerrë dhe ta krahasojë atë me vetëdeklarimet e shoqërive. Gjithashtu, vetëdeklarimet dhe krahasimet të përfshijnë të dhëna për cilësinë e mineraleve (nivelin e përqëndrimit) dhe vlerat e transaksioneve në tregun vendas dhe tregjet e eksportit. Çmimet e transaksioneve në vend mund të krahasohen me çmimet në tregjet ndërkombëtare të mineraleve.

Ky rekomandim është mirëpritur nga MSG dhe është përcjellë për zbatim pranë AKBN. Instuticioni kryen analiza dhe matje të ndryshme, por ende nuk ka konfiguruar të dhënat në formatin që kerkohet nga EITI.

Rakordimi 10 Publikimi i të ardhurave totale që merr Shteti nga industria nxjerrëse

Sistemi qëndror i Thesarit mbledh informacion për çdo pagesë kryer nga taksapaguesit individual, pavarësisht institucioneve që mbledhin këto të taksa ose sektorit ekonomik ku vepron taksapaguesi. Siç është rekomanduar në 7.2.1, nëpërmjet bashkëpunimit me ekipin e raportimit të Qeverisë, MSG mund të marrë të dhëna të plota për të ardhurat gjeneruar nga sektori nxjerrës dhe i hidro-energjisë. Kjo mund të arrihet duke mbajtur një regjistër të përditësuar të licensave në sektor me të dhëna të sakta për numrin e licensës dhe numrin e identifikimit tatimor. Sistemi i informacionit të Qeverisë mund të përdorë të dhënat nga ky regjistër për të prodhuar raportet. Nëse kjo nuk mund të realizohet në një periudhë

afatshkurtër apo afatmesme, Administratori i Pavarur, Deloitte Audit Albania rekomandon vlerësimin e mundësisë për të marrë këtë informacion nga sistemet e informacionit të agjencive qeveritare që arkëtojnë taksa në sektor si tatimet, doganat, dhe NJQV-të, të cilat përfaqësojnë njëkohësisht agjentë të rëndësishëm tatimorë. Përveç përmbushjes së kerkesave të standardit EITI, informacioni i përditësuar nga sistemi i raportimit të Qeverisë do të përmirësojë analizat statistikore në sektor dhe do të mund të krahasohet me informacione të tjera si niveli i prodhimit, struktura e industrisë, numri i licensave, etj.

Implementimi i këtij rekomandimi është i kushtueshëm për agjensitë qeveritare që mirëmbajnë sistemet e tyre. Dizenjimi fillestar i sistemeve nuk ka përfshirë nevoja raportimi të ngjashme me ato të EITI. Megjithatë përgjatë 2016, Drejtoria e Përgjithëshme e Tatimeve dhe ajo e Doganave kanë gjeneruar nga sistemet e tyre, për llogari të raportit EITI të dhëna të kondensuara për industrinë.

Rakordimi 11 *Rezervat*

Ne e kuptojmë se vlerësimi i rezervave kombëtare mund të kërkojë shumë vite dhe përbën një kosto të rëndë në Buxhetin e Shtetit. Megjithatë, rezervat janë të rëndësishme për të siguruar informacion kontekstual për vlerën e përgjithshme të pasurisë kombëtare në përputhje me kërkesat e kapitullit 3 të standardit EITI. Administratori i Pavarur, Deloitte Audit Albania rekomandonë që MEI të vlerësojë përfitimet përkundrejt kostove për vlerësimin e rezervave në të gjithë vendin dhe të caktojë prioritetet për zonat me interes të lartë. Gjithashtu, informacioni koherent për rezervat e provuara dhe të mundshme kombinuar me kontroll efektiv të aktiviteteve të kërkimit dhe nxjerrjes së naftës dhe mineraleve në vend, mund të ndihmojë në planifikimin efektiv të prodhimit dhe atë fiskal si dhe parandalimin e abuzimeve me burimet kombëtare. Ky aktivitetet është në prioritetet e MEI, po implementimi i këtyre rekomandimeve kërkon proçese dhe resurse të dedikuara.

Rakordimi 12 *Mbajtja e një regjistri të përditësuar publik të liçensave dhe koncesioneve*

Vendet anëtare të EITI-t duhet të mbajnë një regjistër publik ose sistem kadastër me informacioin më koherent dhe më të plotë se ai që mban për çdo liçensë dhënë shoqërive përfshirë:

- Mbajtësin e licensës;
- Koordinatat e zonës së licensës;
- Datën e aplikimit, datën e dhënies dhe kohëzgjatjen e licensës; dhe
- Në rastin e liçensave të prodhimit, mineralin e prodhuar.

Regjistri i licensave apo kadastra do të përfshijë informacion për të gjitha licensat e mbajtura nga të gjitha subjektet, përfshirë edhe shoqëritë, individët apo grupet që nuk janë përzgjedhur për rakordim sipas standardit EITI, sepse pagesat tyre paraqiten nën pragun e materialitetit të përcaktuar. Siç është shpjeguar edhe më herët në këtë kapitull, mbajtja e një regjistri të përditësuar publik do të kontribuojë në përmirësimin e raportimit të të ardhurave të qeverisë nga këto sektorë. Për më tepër, të dhëna të sakta mbi të licensuarit, numrat e identifikimit tatimor (NUIS), si dhe detajet e kontaktit, adresa, etj. do të lehtësojnë komunikimin me subjektet e përzgjedhura për të raportuar sipas EITI.

MEI është në proçes të ndërtimit të rregjsitrit online të të liçensuarve në industri. Ndërkohë, për efekte të raportimit EITI dhe me kontributin dokumentar të AKBN, ky rregjistër është publkuar nga EITI Albania.

Rakordimi 13 Transparenca mbi alokimin e licensave

Administratori i Pavarur, Administratori i Pavarur, Deloitte Audit Albania rekomandon që MEI të publikojë në faqen e saj të internetit metodat për alokimin e licensave, kriteret e përdorura për vlerësimin dhe emrat aplikantëve jo-fitues. Ky publikim do të rrisë transparencën e proçesit dhe do të kontribuojë në përmirësimin e negociatave dhe në efektivitetin e procesit. Përveç kësaj, Shqipëria ka nënshkruar disa marrëveshje investuese me shumë vende (lista e plotë e traktateve në fuqi është dhënë në http://investmentpolicyhub.unctad.org/IIA/CountryBits/2çiiaInnerMen).

Këto marrëveshje imponojnë kërkesa strikte për transparencën e procesit të licensimit dhe procedurat e prokurimit. Në këto rrethana, mungesa e transparencës dhe proçeset joefektive të licensimit mund ta ekspozojnë vendin kundrejt pretendimeve në arbitrazh ndërkombëtar.

MEI ka publikuar në faqen e saj web, Termat kryesore të marrëveshjeve koncesionare dhe ato hidrokarbure.

Termat të caktuara të marrëveshjeve hidrokarbure konsiderohen konfidenciale dhe nuk publikohen aktualisht. Në mënyrë që këto marrëveshje të publikohen duhet që të dy palët – shteti dhe operatori të japin pëlqim eksplicit.

Sa i përket sektorit minerar, MEI publikon njoftimet e tenderit, termat e referencës dhe kriteret e vlerësimit të ofertave në faqen e saj: www.energjia.gov.al dhe në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik: www.app.gov.al. Agjencia e Prokurimit Publik (APP) qe është një agjenci publike që i raporton drejtpërdrejt Kryeministrit. APP-ja mbikëqyr aktivitetin e prokurimit publik, duke përfshirë liçensat e minierave dhe koncesioneve.

Rakordimi 14 ***Zbatimi legjislacionit lidhur me rentën minerare***

Në kuadrin e transparencës për shpërndarjen e rentës Deloitte Audit Albania rekomandon që Grupi Shqiptar i Punës të kërkojë përmirësimin e proçedurave plotësuese për adresimin e rasteve të tilla. Proçedurat plotësuese mund të përfshijnë:

- Krahasimin e rentës së mbledhur me atë të shpërndarë
- Komunikimin me NJQV-të për tu siguruar që kanë përfunduar proçedurat rakorduese në mbyllje të vitit
- Investigimin e mëtejshëm me drejtoritë përgjegjëse për tatimet dhe doganat për burimin gjenerues së rentës ende e pashpërndarë, etj

Ky rekomandim ka filluar të implementohet nga ana e EITI përgjatë 2016. Ne kemi kryer takime në të gjitha bashkitë ku ka veprimtari minerare për ti ndërgjegjësuar drejtuesit mbi potencialin e këtij kontributi financiar.

Gjithashtu edhe me MF janë kërkuar raporte të hollësishme mbi mënyrën se si po llogaritet dhe po shpërndahet renta e grumbulluar. Proçesi ende ka të meta që gjenerohen edhe si pasoje e reformes adminsitrative në proçes implementimi.

Rakordimi 15 ***Kuadri rregullator për raportimin EITI***

Në mënyrë që të forcojë kuadrin rregullator për raportimin e pagesave dhe për të kapërcyer pengesat e listuara më sipër, Administratori i Pavarur, Deloitte Audit Albania që MSG të përshtasë dhe të hartojë akte rregullative plotësuese që adreson të gjitha aspektet si:

- Analiza paraprake për përcaktimin e materialitetit dhe pagesat e përfhsira në raportimin
- Koha dhe forma e raportimit nga të liçensuarit
- Koha dhe forma e raportimit nga ana e institucioneve publike që mbledhin pagesat
- Koha dhe forma e raportimit të informacionit kontekstual
- Niveli i proçedurave për auditimin e çdo raportimi
- Format për të zgjidhur aspektet e konfidencialitetit etj.

Aktet rregullative duhet të përcaktojnë afatet për një proçes efektiv dhe të lejojë kohë të mjaftueshme që çdo shoqëri dhe institucion publik raportues të planifikojë dhe t'i përgjigjet kërkesave për raportimin EITI në afat. Formularët e raportimit dhe instruksionet përkatëse duhet të përditësohen për ndryshime në qëllimin e punës dhe kërkesat për raportim, ndryshime në rregullore, si dhe fakte të reja që ndikojnë industrinë nxjerrëse (p.sh. taksa dhe përfitime të reja të zbatuara, investime të reja në industri etj.) Përzgjedhja e subjekteve raportuese duhet të planifikohet dhe të komunikohet disa muaj përpara fillimit të punës për rakordimin e pagesave. Ne sugjerojmë, të kërkohet nga të gjithë të liçensuarit (kur kjo është e mundur) të dorëzojnë raportimin në rrugë elektronike nëpërmjet faqes së internetit ose emailit. Puna rakorduese mund të kryhet për një përzgjedhje e kryer sipas qëllimit të raportimit EITI dhe duke reflektuar ndryshimet në sektor. Formularët e miratuar nga MSG mund të publikohen në faqen e internetit të AlbEITI-it, nga ku të liçensuarit të kenë mundësi t'i shkarkojnë, t'i plotësojnë dhe t'i ngarkojnë përsëri nëpërmjet një portal-i të dedikuar, nëse sistemet e EITI Shqipëri e mundësojnë këtë proçes. Formularët përfundimtarë e të firmosur mund të dërgohen në vijim me email ose të ngarkohen në të njëjtin portal. Raportimet e marra nga të licensuarit dhe jo të përzgjedhura për rakordim mund të paraqiten si deklarime të njëanshme në raport dhe të gjithë raportimet bashku të krahasohen me të statistika për prodhimin dhe arkëtimet totale të raportuar nga institucionet qeveritare etj.

Përcaktimi i afateve për dorëzimin e deklaratave dhe procesin e rakordimit.

Afati për dorëzimin e raportimit duhet të planifikohet në kohë dhe të përfshihet në skedulin e raportimeve të të licensuarve. Si rrjedhojë, koha e nevojshme për mbledhjen e raportimit nga bizneset pritet të ulet dhe gjithashtu priten përmirësime në saktësinë e raportimit. Shoqëritë raportuese dhe institucionet qeveritare duhet të raportojnë në të njëjtin afat.

Fillimi i muajit maj të vitit pasues kalendarik mund të përcaktohet si afati i fundit për dorëzimin e formularëve të plotësuar dhe puna rakorduese të kryhet gjatë muajit maj dhe qershor.

Bazuar në gjetjet e identifikuara gjatë përgatitjes së raporteve EITI 2013 dhe 2014, ne identifikuam nevojën të punojmë për rishikimin dhe adoptimin e kuadrit ligjor shqiptar kundrejt kërkesave të Standartit EITI dhe inisiativave të tjera në mënyrë të atillë që të mundësohet një rrjedhë normale të proçesit të raportimit EITI si dhe puna për hartimin dhe miratimin e dispozitat ligjore dhe ndërlidhjen me ligje të tjera.

Analiza e kuadrit ligjor Shqiptar nënvizoi boshllëqet dhe identifikoi ndryshimet dhe/ose amendimet që duhet të bëhen në atë pjesë të ligjeve që ndërlidhet me proçeset EITI me qëllimin që të sigurohet jo vetëm përputhja me standartin EITI por mbi të gjitha, transparenca dhe llogaridhenia në mënyrën se si të ardhurat e gjeneruara nga industritë nxjerrëse në Shqipëri, mblidhen dhe përdoren.

Ndonjë pikë e fortë ose dobësitë e identifikuara në proçesin EITI

Pikat e forta

Sekretariati Shqiptar EITI pati një rritje të aktiviteteve ndërvepruese përgjatë vitit 2016 dhe një rritje të bashkëpunimit mes kompanive operuese në vend dhe Sekretariatit EITI.

Tashme raportimi per EITI nuk eshte nje proces i ri. Palet jane te informuara dhe e njohin procesin. Kompanite e medha e kane konsoliduar raportimin ndersa agjensite shteterore jane te qarta mbi kerkesat. Miratimin e përfshirjes në Raportin EITI 2015 të pagesave për taksat lokale me kufi materialiteti 5000 USD, pasqyrimin në mënyrë të disagreguar në Raportin EITI 2015 të pagesave të bëra për vepra publike dhe infrastrukturë sipas detyrimeve kontraktuale, si dhe pagesat apo investimet që bëhen nga kompanitë në kuadër të përgjegjësisë sociale me kufi materialiteti 5000 USD.

Dobësitë

Megjithëse EITI Shqipëri deri më tani ka publikuar 6 Raporte EITI, duke dhënë informacione të detajuara dhe koherente mbi zhvillimet e industrisë nxjerrëse në vend, duke zhvilluar takime dhe seminare me grupet e interesit në zonat ku është e përqëndruar industria nxjerrëse, vihet re se informacioni që qytetarët kanë për EITI -Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse është ende i ulët. Ne konstatojmë që kostot e implementimit të një fushate të mirëfilltë ndërgjegjësuese janë përtej kapaciteteve tona si nga ana e burimeve njerezore ashtu edhe nga ana financiare. Grupet e interesit që angazhohen pranë EITI kanë veprimtari të dobët e cila sipas tyre vjen nga mungesa e mbështetjes me fonde.

Gjithashtu, pikë e dobët e proçesit është që raportimet EITI shihen ende si raportime ad-hoc. që fillojnë dhe mbarojnë si projekt.

Institucionet qeveritare kryesisht, ende nuk e shohin ende si një proçes i cili duhet të integrohet dhe standartizohet në proçeset e brendëshme të institucioneve dhe të prodhojë rezultatet e veta në vazhdimësi.

Kostoja totale e implementimit

Sekretariati Shqiptar EITI për vitin 2016 u mbulua nga fondet e Buxhetit të Shtetit, nga fondet e projektit grand TF0A1769 i Bankës Botërore si dhe nga fondi donatorë të tjerë. Financimi nga Buxheti i Shtetit për vitin 2016 për Sekretariatin ishte në nivelin e 12,249 mijë lekë.

Projekti Grand TF14999 i Bankës Botërore është realizuar i plotë gjatë vitit 2015 dhe veprimet financiare janë realizuar, mbyllur dhe rakorduar sipas marrëveshjes me Bankën Botërore brenda muajit Prill 2016.

Projekti Grand TF0A1769 i Bankës Botërore për vitin 2016 ishte parashikuar në nivelin e 14.255 mijë lekë (me kursin e këmbimit 125 lekë/usd) ose 114 mijë usd dhe financoi kryesisht realizimin e Raportit EITI 2015 nga Administratori i Pavarur, konsulencë, aktivitete seminare, trajnime etj. në vlerën e 13.652 mijë lekë (me kursin e këmbimit 122.6 lekë/usd).

Fondi gjëndje nga donatorë të tjerë u përdor për pagesën e konsulentëve dhe për aktivitetet EITI të përmendura në këtë raportim.

Stafi faktik i Sekretariatit Shqiptar EITI për periudhën 2016 ka qënë 8 punonjës, nga të cilët 7 punonjës me kohë të plotë dhe 1 punonjës me kontratë nga kontingjenti i studentëve të rinj të sapombaruar kundrejt 9 punonjës te parashikuar.

Më poshtë një informacion i detajuar për fondet e financuara për vitin 2016.

FONDET GJITHSEJ	PARASHIKIMI	REALIZIMI	%
A. *Buxheti Shtetit*	12,249 mijë lekë	12,249mijë lekë	100
Pagat	7,178 mijë lekë	7,178 mijë lekë	
Sigurimet shoq. e shend.,TAP	3,042 mijë lekë	3,042 mijë lekë	
Shpenzime të tjera Operative	2,029 mijë lekë	2,029 mijë lekë	
B. *Banka Botërore* (TF0A1769)			
Në usd	114,039 USD	111,368 USD	97.6
Ose ne lekë	14,255 mijë lekë	13,651 mijë lekë	95.7
Gjendja në fillim vitit		0	
Gjendje në fund vitit		344 mijë lekë	

FONDET GJITHSEJ	PARASHIKIMI	REALIZIMI	%
C. Donatorë të tjerë			
a. Gjendja në fillim vitit		1,481 mijë lekë	
Konsulencë për ndjekje sektorit H/C dhe mbyllje financiare të projektit te BB	-	417 mijë lekë	
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	-	67 mijë lekë	
Konferenca, trajnime etj. jashtë vendit	-	104 mijë lekë	
Konferenca, trajnime, aktivitete etj. brenda vendit	-	175 mijë lekë	
Mbulim TVSH për projektin e BB	-	241 mijë lekë	
Shpenzime mirëmbajtje web në internet	-	15 mijë lekë	
Komisione bankare	-	9 mijë lekë	
Gjendje në fund vitit	-	153 mijë lekë	

Është diskutuar veprimtaria e raportit përtej MSG-së

Veprimtaria e aktiviteteve vjetore 2016, është diskutuar në mbledhjet e EITI Albania MSGt EITI, me kontribuesit dhe të angazhuarit në procesin EITI, shoqërinë civile, kompanitë operuese në vend, me pushtetin qëndror dhe atë lokal dhe me banorët e zonave me aktivitet të industrisë nxjerrëse. Sekretariati Shqiptar EITI morri në konsiderat sygjerimet e ndryshme që erdhën nga secila palë e interesuar.

Për këtë referohu në seksionin "aktivietete të komunikimit" më sipër.

Detaje mbi antarësinë e MSG gjatë periudhës

Numri i anëtareve të MSG për vitin 2016 ka qenë me pesë (5) përfaqësues nga Shoqëria Civile, pesë (5) përfaqësues nga kompanitë nxjerrëse dhe shtatë (7) përfaqësues nga qeveria. Ministria e Financës, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Ministria e Drejtësisë zëvendësuan anëtarët përkatës të EITI Albania MSGt me anëtarë të rinj. Znj. Madlina Puka, përfaqësuese e shoqërisë civile, jep dorëheqjen nga detyra e saj funksionale në EITI Albania MSGn EITI. Vendi i saj në EITI Albania MSGn EITI mbetet akoma dhe sot vakant. Theksojmë që në çdo takim të MSG njoftohen të gjithë kontribuesit që kanë qenë pjesë e nismës EITI që në themelimin e saj ku dhe çdo sugjerim nga ana e tyre dëgjohet dhe merret në konsideratë.

EITI Albania dhe MSG punuan përgjatë Vitit 2016 edhe rregulloren e re veprimtarisë së MSG-së nën dritën e zhvillimeve të proçesit EITI në Shqipëri, konsolidimit të veprimtarisë së saj dhe kërkesave të reja të standartit EITI. Pasi mori miratimitin e MSG, rregullorja e re u nënshkrua në Dhjetor 2016 nga Miinsitri i Energjisë Z. Damian Gjiknuri dhe u publikua në faqen zyrtare të EITI Albania.

Rregullorja e re përcakton politikat për organizimin dhe funksionimin e MSG-së, rolin dhe përgjegjësitë e anëtarëve, detyrat funksionale të saj, rolin e secilit prej grupimeve brënda MSG-së, zgjedhjen, mandatin dhe zëvendësimin e anëtarëve të saj. Në të janë përcaktuar kriteret për vlerësimin e performancës dhe modalitetin e vendimmarrjes, organizimit dhe dokumentimit të mbledhjeve, etj.

E aprovuar nga MSG:

Datë: _____

Foto të aktiviteteve 2016

Dorina Çinari, Drejtuese e EITI Albania në emisionin Argument në TV SCAN

7 Janar 2016

Konferencë për shtyp- Raporti EITI 2013-2014

20 Janar 2016

Konferenca EITI në Peru – Ministri Damian Gjiknuri

24-25 Shkurt 2016

Kongresi për Industrinë Minerare

27-28 Prill 2016

Konferencë për shtyp- Raporti EITI 2013-2014

3 Maj 2016

MSG

6 Maj 2016

Misioni i Bankës Botërore – Trajnim për antarët e MSG

9 Qershor 2016

Trajnim mbi Nismën EITI- KFOS dhe Euroasia Hub

24-25 Qershor 2016

Seminar informues mbi Raportimin EITI 2015

6 Shtator 2016

Anketa EITI - Vlorë

20 Shtator 2016

Aktivitet i Shoqërisë Civile

27 Shtator 2016

Anketa EITI – Librazhd -Përrenjas

3 Tetor 2016

Anketa EITI – Librazhd -Përrenjas

5 Tetor 2016

Shkëmbim eksperiencash mes Sekretariatit Shqiptar EITI dhe Qeverisë së Kosovës

6 Tetor 2016

Anketa EITI në Rrëshen

13 Tetor 2016

Anketa EITI në Kukës

17 Tetor 2016

Anketa EITI në Tiranë

24 Tetor 2016

Edicioni i Tretë i Panairit - Energjia dhe Ndërtimi

27-29 Tetor 2016

MSG

31 Tetor 2016

Anketa EITI në Vaun e Dejës

3 Nëntor 2016

Takim me komunitetin në zonën Marinzës, Roskovec

2 Nëntor 2016

Takime të drejtpërdrejta në kantieret e Punës

22 Nëntor 2016

Tryezë e rrumbullakët me operatorët e industrisë nxjerrëse në Qarkun e Kukësit

13 Dhjetor 2016

EITI Albania vizitë në Qëndrën e Drejtimit dhe Kantierin e Minierës Albchrome

15 Dhjetor 2016